

VARFËRIA E FËMIJËVE NË KOSOVË



Dokumenti me opsione për politika & Raporti përmbledhës

unicef 
unite for children

VARFËRIA E FËMIJËVE NË KOSOVË
Dokumenti me opsione për politika
& Raporti përmbledhës

Raporti i përgatitur nga:

Paul Stubbs dhe Danijel Nestiq, Instituti Ekonomik, Zagreb, Kroaci

© United Nations Children's Fund (UNICEF)

Maj 2010

Nevojitet leje për të ripublikuar cilëndo pjesë të këtij raporti. Ju lutem kontaktoni Zyrën e UNICEF-it në Kosovë (Ali Pashë Tepelena Nr 1, 10 000 Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 249 230/1/2; Fax: + 381 38 249 234; E-mail: akuriu@unicef.org ose prishtina@unicef.org). Leja do të ju ipet lirshëm organizatave arsimore dhe jo profitabile.

Qëndrimet në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e UNICEF-it.

Dizajni:

www.xhad.net

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
MIRËNJOHJE	5
DOKUMENTI ME OPSIONE PËR POLITIKA	6
1 HYRJE	15
1.1.Varfëria e fëmijëve në kontekstin Evropian	15
1.2.Kosova: Sfidat e mbrojtjes sociale	16
1.3.Ky studim	18
2. PROFILI I VARFËRISË SË FËMIJËVE NË KOSOVË	20
2.1.Norma e varfërisë së fëmijëve në Kosovë.....	21
2.2.Fëmijët dhe brishtësia materiale dhe e strehimit	25
3.ROLI I TRANSFEREVE SOCIALE DHE HAPËSIRA FISKALE	28
3.1.Transferet e parave të gatshme	29
3.2.Ndikimi i transfereve sociale në varfërinë e fëmijëve	29
3.3.Skema e ndihmës sociale	30
3.4.Hapësira fiskale dhe drejtimi strategjik	36
3.5.Nismat nga partnerët zhvillimor	37
4.OPTIONET PËR POLITIKA DHE ZBUTJA E VARFËRISË	38
4.1.Ndryshimi dhe plotësimi i skemës së ndihmës sociale	39
4.1.1. Shfuqizimi i pikës ndërprerëse në ndihmën e Kategorisë II për familjet me fëmijë kur fëmija arrin moshën 5 vjeçare	39
4.1.2. Shtimi i një shume shtesë për beneficion të çdo fëmije të moshës në mes 6 dhe 18 vjeçare	39
4.1.3. Shfuqizimi i shumës maksimale të beneficionit për ekonomitë e mëdha familjare	40
4.1.4. Ngritja e shumës së beneficionit të ndihmës sociale në përgjithësi	41
4.2.Paraqitja e skemës së beneficionit për fëmijë	41
4.2.1. Paraqitja e skemës universale të beneficionit për fëmijë si shtesë ose në vend të skemës së tanishme të ndihmës sociale	41
4.2.2. Paraqitja e skemës së beneficionit për fëmijë me verifikim të mjeteve materiale.....	43
5. PËRFUNDIME DHE HAPAT E ARDHSHËM	44
REFERENCAT	48

SHKURTESAT

KMEF	Konsumi Mesatar i Ekonomisë Familjare
bps	Pikë bazë të përqindjes
ShF	Shtesat për Fëmijë
BOK	Banka Qendrore e Kosovës
EQL-ShPC	Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Shtetet e Pavarura të Commonwealth-it
DFID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
BE	Bashkimi Evropian
€	Euro.
IHD	Investimet e huaja direkte
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
IPA	Instrumenti i asistencës para anëtarësimit
MIP	Memorandum i përbashkët për gjithëpërfshirje sociale
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
NS	Ndihma Sociale
EJL	Evropa Juglindore
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

MIRËNJOHJE

'Zbutja e varfërisë fillon me fëmijët', e tërë bota është pajtuar me këtë. Gjashtë nga tetë Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit kanë të bëjnë në mënyrë direkte me fëmijët. Asnjë shoqëri nuk ka pasur rezultat në zbutjen e varfërisë pa investim të madh dhe të qëndrueshëm për fëmijët. Investimi në shëndetin, ushqyeshmërinë, zhvillimin e edukimin social, kognitiv dhe emocional të fëmijëve dhe në arritjen e barazisë gjinore, përveç se është investim në shoqëri më demokratike dhe të barabartë është edhe investim në shoqëri më të shëndetshme, më të shkolluar dhe më produktive. Në aspektin moral, investimi për fëmijët është gjëja e duhur për t'u bërë, por është gjithashtu investim ekonomik me vlera të mëdha të kthimit.

Duke kontribuar në studimin global të UNICEF-it për "Varfërinë e fëmijëve dhe pabarazinë", ky raport ka për qëllim të fuqizojë pozitën e fëmijëve në agjendën e politikbërjes, duke influencuar politikat ekonomike dhe sociale të cilat ndikojnë në alokimin e fondeve dhe duke i vendosur fëmijët si prioritet në programet nacionale.

I jemi mirënjohës, për ekspertizën e tyre, Paul Stubbs dhe Danijel Nestiq nga Instituti Ekonomik në Zagreb, Kroaci për draftimin e opsioneve të politikave dhe të raportit përmbledhës mbi "Varfërinë e fëmijëve në Kosovë" duke shfrytëzuar të dhënat nga dy studime të UNICEF-it në Kosovë të përfunduara më 2008 nga Yekaterina Chzhen, Universiteti i Jorkut në Angli dhe më 2009 nga Franziska Gassmann dhe Keetie Roelen nga Universiteti i Mastritit në Holandë. Gjithashtu i falenderohemi personelit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqeniës Sociale në Kosovë për kontributin e dhënë në këtë studim.

Realizimi i këtij studimi është financuar nga Ministria për Punë të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Austrisë.

*Johannes Wedenig
Kryesues i Zyrës
UNICEF Kosovë*



DOKUMENTI ME OPSIONE
PËR POLITIKA

DOKUMENTI ME OPSIONE PËR POLITIKA¹

VARFËRIA E FËMIJËVE NË KOSOVË DHE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Studimet e fundit të kryera nga UNICEF-i në Kosovë tregojnë qartë se fëmijët janë në rrezik dukshëm më të lartë të varfërisë në Kosovë në krahasim me popullsinë në përgjithësi. Duke shfrytëzuar kufirin e varfërisë (në përgjithësi të pranueshëm) të konsumit prej 1.417€ për person në ditë, në bazë të të dhënave nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2006/7, 46.2% e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri, dhe 48.6% e fëmijëve të moshës 0-19 vjeçare jetojnë në varfëri. Me rrezikun më të lartë të varfërisë përballen fëmijët që jetojnë në ekonomitë familjare me tre ose më shumë fëmijë, fëmijët e moshës 0-14 vjeçare, fëmijët e prindërve të papunë, fëmijët në ekonomitë familjare që marrin ndihmë sociale, dhe fëmijët në ekonomitë familjare me nivel të ulët të arsimit. Përderisa rreziku i varfërisë është më i ulët për fëmijët ku së paku një familjar është i punësuar, fëmijët në ekonomitë familjare që pranojnë pagë përbëjnë 36% të të gjithë fëmijëve që jetojnë në varfëri në Kosovë.

Bashkimi Evropian është duke udhëhequr rrugën në drejtim të përpjekjes së përbashkët në luftimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve, duke njohur natyrën shumë dimensionale të problemit. BE njeh se varfëria dhe përjashtimi i fëmijëve kanë kosto të larta individuale dhe sociale, ku fëmijët e rritur në varfëri janë në rrezik serioz për shëndetin, arsimim të ulët, pamundësinë për të gjetur punë më vonë gjatë jetës, dhe në përgjithësi humbjen e zgjedhjeve. Prandaj investimi në fëmijë është me rëndësi jo vetëm në kuptim të nxjerrjes së fëmijës jashtë varfërisë por gjithashtu është një mënyrë efikase dhe kosto efektive e sigurimit se brezat e tashëm të fëmijëve bëhen qytetarë të rritur të shëndetshëm, produktiv dhe aktiv. Luftimi i varfërisë është i domosdoshëm për të luftuar përcjelljen e varfërisë në mes brezash, dhe për të siguruar se të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh rrethanat e tyre fillestare jetësore dhe prejardhjen sociale, gëzojnë mundësitë e barabarta në shoqëri. Çështja e varfërisë së fëmijëve zë vend të lartë në agjendën e BE-së në vitin 2010, Viti Evropian për luftimin e varfërisë dhe përjashtimit social.

Është nxjerrë mësimi se pa politika gjithëpërfshirëse për fëmijë dhe familje, varfëria e fëmijëve ka gjasa të ulëta që të reduktohet thjesht vetëm si rezultat i politikave të përgjithshme kundër varfërisë. Kërkohej një kombinim i përshtatshëm

¹ Ky dokument me opsione për politika nga autorët nga Instituti i Ekonomik në Zagreb, Kroaci (Paul Stubbs dhe Danijel Nestic) bazohet në raportin më të gjatë përmbledhës 'Varfëria e fëmijëve në Kosovë', duke shfrytëzuar të dhënat nga dy studimet e kryera në vitin 2008 dhe 2009 nga Universiteti i York, Mbretëri e Bashkuar dhe Universiteti i Maastricht në Holandë.

i vullnetit politik, kapacitetit teknik dhe hapësirës fiskale. Përderisa BE nuk parashkruan politikat e veçanta për reduktimin e varfërisë të fëmijët, është e qartë se shtetet anëtare që shpenzojnë pjesë më të larta të BPV-së së tyre në mbrojtjen sociale (me përjashtim të pensioneve) kanë tendencë që të kenë shkallë më të ulët të varfërisë së fëmijëve. Ofrimi i kujdesit për fëmijë të përbalueshëm financiarisht dhe shërbimeve përkatëse të bazuara në komunitet gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në reduktimin e varfërisë së fëmijëve dhe luftimin e përjashtimit social.

ROLI I TRANSFEREVE TË PARAVE TË GATSHME

Kosova nuk ka skemë të beneficionit për të papunët, nuk ka shtesa të amësisë dhe nuk ka skemë të beneficionit për fëmijët. Ajo ka skemën e pensionit social, skemën për invalidët e luftës dhe familjet e të rënëve gjatë luftës, dhe skemën e pensionit invalidor. Përveç kësaj, Kosova ka paraqitur një skemë të re në vitin 2009 që shënjestronte familjet që kujdesen për fëmijët me paaftësi të rënda dhe të përhershme. Hëpërhë nga kjo skemë përfitojnë 2,158 përfitues të cilët pranojnë nga 100€ në muaj. Transferi kryesor i parave të gatshme për familjet e varfra është skema e ndihmës sociale e financuar nga buxheti i Kosovës. Janë dy kategori të ndihmës sociale: Kategoria I mbulon ekonomitë familjare të varfra ku asnjë familjar nuk është në gjendje që të punojë ose ku i rrituri i vetëm që është i aftë të punojë kujdeset përherë për një person të varur. Kategoria II mbulon ekonomitë familjare të pranueshme ku familjarët e rritur janë të papunë dhe ku së paku një fëmijë është i moshës 5 vjeçare ose nën atë moshë ose është fëmijë jetim gjer në moshën 15 vjeçare.

Në vitin 2009, normat u ngritën ashtu që norma bruto standarde e ndihmës sociale për ekonomitë familjare me një person është 40€ në muaj, dhe 55€ për ekonominë familjare me dy persona, me 5€ shtesë për muaj për çdo familjar shtesë të ekonomisë familjare, gjer në maksimum 80€ për ekonomitë familjare me 7 ose më shumë anëtarë. Në çdo vit gjer në dhjetor të vitit 2008, numrat e personave që pranonin ndihmë sociale ranë dukshëm. Pas rritjes së beneficioneve në janar 2009, dhe transferimit të Qendrave për Punë Sociale nën përgjegjësi të komunave, numri i aplikuesve u ngrit, edhe pse numri i aplikuesve të Kategorisë II vazhdoi të bie (Tabela 1).

Tabela 1: Numri total i ekonomive familjare që kërkojnë ndihmë sociale

	Kategoria I	Kategoria II	Gjithsej
Dhjetor 2008	17,388 (100)	16,919 (100)	34,307 (100)
Dhjetor 2009	19,022 (109.4)	16,674 (98.6)	35,654 (104)


Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Sipas vlerësimit të fundit të varfërisë nga Banka Botërore, skema është shumë mirë e shënjestruar ku 78% e fondeve shkon te të varfrit dhe 45% e fondeve te kuintali i poshtëm (figura 1 më poshtë) por ka mbulim të kufizuar duke mbuluar vetëm 23% të të varfërve. Me fjalë tjera, rreth 695,000 persona të varfër në Kosovë nuk pranojnë beneficione të ndihmës sociale. Figura 1 gjithashtu tregon përqindjen e BPV-së që shpenzohet në ndihmë sociale në krahasim me fqinjët, regjionin më të gjerë dhe shtetet e OECD-së. Në kuptim të fëmijëve të varfër nuk ka kurrfarë skeme që mbulon fëmijët e varfër në ekonomitë familjare që



pranojnë paga. Gjithashtu nuk ka skema për të mbuluar ata që do të ishin të pranueshëm për ndihmën nga kategoria II por fëmija më i vogël i të cilëve nuk është 5 vjeç ose nën moshën 5 vjeçare. Gjatë vitit 2009, 2.951 ekonomi familjare të varfra humbën beneficionet e tëra të tyre pasi që fëmija më i vogël mbushi 6 vjet.

Figura 1. Krahasimet regjionale



Burimi: Gueorguieva, A. (2008) 'Program i mirë, Investim i mirë: Dokument politik për programin e Kosovës për ndihmë sociale', Uashington, Banka Botërore, prill.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) e Kosovës përfshinë zotimin për të ngritur mirëqenien sociale duke përfshirë një numër të ndryshimeve në Skemën e Ndihmës Sociale, disa nga të cilat janë zhvilluar në Draftin e Letrës së Bardhë për politika sociale dhe u përfshinë në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Ndihmë Sociale që u kthye nga Parlamenti te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në KASH dhe përmes Projektit të propozuar shumëdonatorësh/Banka Botërore për politika të zhvillimit të punësimit të qëndrueshëm (SEDPP), ekziston synimi për të lidhur Ndihmën Sociale të Kategorisë II më ngushtë me gatishmërinë për përfshirje në punët publike dhe trajnim për reintegrim në tregun e punës.

Në Kosovë ekziston hapësirë e kufizuar fiskale me shpenzime vjetore për ndihmë sociale prej vetëm 18.3% të të gjitha shpenzimeve për beneficione për mirëqenie sociale në vitin 2008, që ishte rreth 1 milion € më pak sesa që ishte buxhetuar dhe ka rënë prej 24% në vitin 2007 dhe 35% në vitin 2004. Për dallim pensionet bazë të pleqërisë përbënin 46% të shpenzimeve në vitin 2008, dhe pensionet në përgjithësi përmbi 56% të të gjitha shpenzimeve.

ZBUTJA E VARFËRISË SË FËMIJËVE NË KOSOVË

Ekziston një numër i opsioneve të politikave që mund të kontribuojnë në zbutjen e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve në Kosovë. Këto janë paraqitur më detalisht në Raportin Përmbledhës. Në kuptim të politikave afatshkurtra, ato më kritiket kanë të bëjnë me Ligjin për Ndihmën e Skemës Sociale që duhet të përgatitet dhe sa më shpejt t'i dërgohet Parlamentit. Ky ligj duhet të bazohet në tri plotësime dhe ndryshime kryesore që ishin përfshirë në projekt Ligjin që u kthye mbrapsht nga Parlamenti, dhe në Draftin e Letrës së Bardhë, dmth:

- *Indeksimi i niveleve të beneficionit në të kaluarën për të mbuluar koston e ngritur të shportës së ekonomisë familjare. Ngritja është kalkuluar në 27.35%. Kalkulimet sugjerojnë se ngritja e tillë do të reduktonte varfërinë e përgjithshme për rreth 2.8 pikë bazë të përqindjes (bps) dhe varfërinë të fëmijët për 3.5 bps, gjithashtu me reduktime të rëndësishme në nivelet e varfërisë ekstreme, në veçanti në mesin e fëmijëve, dhe në dallimin e varfërisë.*
- *Ngritja e beneficionit që i paguhet fëmijëve të moshës shkollore (dmth 6-18) për 5€ me kusht që ata vijojnë rregullisht mësimin. Kjo do të kishte ndikim të ngjashëm dhe plotësues në normat e varfërisë dhe dallimet e varfërisë.*
- *Mënjanimi i kufijve të sipërm të beneficioneve të ekonomive familjare ashtu që familjet me 8 ose më shumë anëtarë të pranojnë nga 5€ shtesë për secilin anëtar. Kjo nuk do të vlejë për një numër të madh të familjeve prandaj nuk do të kishte ndikim të madh në normat e përgjithshme të varfërisë, por me kosto relativisht të ulët, do të reduktonte dukshëm varfërinë në ekonomitë e mëdha familjare.*

Marrë së bashku, tri masat mund të reduktojnë normat e varfërisë së fëmijëve në Kosovë gjer në 8 bps, duke ulur normën në rreth 40%.

Përveç kësaj vlerësimi i radhës i varfërisë nga Enti Statistikor i Kosovës/Banka Botërore, duke shfrytëzuar të dhënat e fundit nga ABEF do të duhet të ketë përqendrim special në varfërinë e fëmijëve përfshirë kalkulimin e normave të varfërisë, në normat e rrezikut për fëmijët e moshave të ndryshme, në llojet e ndryshme të ekonomive familjare, në viset rurale dhe urbane, etj. Studimi gjithashtu, nëse është e mundur, do të duhej të nënvizonte skenarët e ndryshëm të politikave për transferet e parave të gatshme dhe të kalkulojë ndikimet e tyre në varfërinë e fëmijëve.

Në aspektin më të gjerë, si pjesë e përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE dhe pjesëmarrje në Metodën e Hapur të Bashkëpunimit për mbrojtjen sociale dhe gjithëpërfshirjen sociale, ekziston nevoja për vëmendje më të madhe ndaj varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve në kontekst të strategjive kombëtare zhvillimore dhe përgatitjen e strategjisë së re për gjithëpërfshirje sociale. Çështja e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve duhet të bëhet çështje diskutimi në Raportin vjetor të Progresit që nxirret nga Komisioni Evropian për Kosovën në Strategjinë e BE-së për Zgjerim si dhe në kuptim të prioritetëve financues të Instrumentit Para Anëtarësimit (IPA).

Një numër i programeve dhe projekteve janë në proces të përcaktimit ose zbatimit, ku të gjitha kanë komponentë që mund të ndërlidhen me çështjet e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Përpyekjet e UNICEF-it për ndërlidhje të ngushtë me partnerët bashkëpunues do të sigurojnë shfrytëzimin në maksimum të mundësive për të siguruar qasjet koherente për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Këto përfshijnë:

- *Projektin shumëdonatorësh/Banka Botërore për politikë të zhvillimit të punësimit të qëndrueshëm (SEDPP).*
- *Mbështetjen e financiar nga BE (IPA) për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).*
- *Programin e propozuar i financiar nga DFID për decentralizimin e Shërbimeve të Kujdesit Social.*

Ekziston nevoja, mbi të gjitha, për të siguruar efikasitet maksimal të lidhjes në mes të transfereve të parave të gatshme dhe shërbimeve të kujdesit në kontekst të decentralizimit, për të siguruar kombinimin më të mirë për fëmijët e rrezikuar dhe të përjashtuar.

Në afat të mesëm mund të ekzistojë nevoja për të siguruar asistencë teknike për Qeverinë (në veçanti për MPMS dhe MEF) me qëllim të ndërtimit të kapacitetit për modelim të politikave dhe skenarëve në kuptim të opsioneve të qarta për reduktim të varfërisë së fëmijëve në Kosovë përmes transfereve të parave të gatshme. Një nga prioritetet e para duhet të jetë eksplorimi i mundësisë së zgjerimit të Ndhmës Sociale të Kategorisë II për ato familje që bien jashtë kritereve të pranueshmërisë vetëm sepse nuk kanë më asnjë fëmijë nën moshën 6 vjeçare por kanë fëmijë të moshës shkollore.

Në afat të mesëm dhe të gjatë Kosova mund të merr parasysh, sikurse shumica e fqinjëve të regjion, paraqitjen e skemës së beneficionit për fëmijë. Përderisa skema e beneficionit universal mujor për fëmijë prej 25€ llogaritet se do të përgjysmojë normat e varfërisë të fëmijët në Kosovë, ajo është e kushtueshme në kontekst të hapësirës aktuale fiskale (rreth 5% e BPV-së). Beneficionet universale ose në bazë të verifikimit të mjeteve materiale në nivel prej rreth 10€ në muaj, për të gjithë fëmijët, për fëmijët nën moshën 5 vjeçare ose për fëmijët 5-15 vjeçar, mund të kenë ndikim të rëndësishëm në normat e varfërisë së fëmijëve, ku norma 10€ i afrohet nivelit të BE-së prej 2% të BPV-së që shpenzohet për beneficionet për fëmijët dhe familjet. Beneficionet universale për fëmijë kanë kosto më të ulët administrative, arrijnë te fëmijët në ekonomitë familjare që pranojnë paga, dhe edhe pse janë më të shtrenjta sesa skemat në bazë të verifikimit të mjeteve materiale, mund të kombinohen me sistemet tatimore për të rikuperuar disa shpenzime për ekonomitë familjare jo të varfra. Kjo gjithashtu mund të jetë mundësia e lidhjes së mbështetjes direkte buxhetore në kuptim të reduktimit të varfërisë dhe përjashtimit të fëmijët dhe sigurimit se buxheti qendror dhe lokal i përgjigjet fëmijëve dhe aspektit gjinor.

Në kuptim të vullnetit politik, ngritja e vetëdijes për varfërinë dhe përjashtimin e fëmijëve në mesin e të gjitha partive politike dhe në veçanti në mesin e parlamentarëve mund të jetë mjet efektiv për sigurimin e ndjeshmërisë më të madhe ndaj fëmijëve në politikë bërjen në përgjithësi. Kjo mund të ndërtohet mbi punën tanimë të kryer me Parlamentarët për çështjet e përfshirjes sociale. Në afat të shkurtër Kosova duhet të përgatis Strategjinë e Përfshirjes Sociale në linjë me ato të kërkuara në kuptim të Memorandumit të Përbashkët të Gjithëpërfshirjes për shtetet kandidate ashtu që brenda saj të kërkohet përqendrimi në qasjen e koordinuar dhe efektive për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve duhet gjithashtu të jetë prioritet brenda strategjisë kombëtare për zhvillim, së bashku me kujdesin më të madh në nivel lokal ndaj bashkëveprimit në mes të transfereve të parave të gatshme dhe shërbimeve sociale, caktimit të prioritetit për arsimin në fëmijërinë e hershme, dhe sigurimin e strategjive të përqendruara për përfshirje të grupeve dhe regjioneve të marginalizuara.



1

RAPORTI PËRMbledhës

1 HYRJE

1.1. Varfëria e fëmijëve në kontekstin Evropian

Gjatë disa viteve të fundit reduktimi i varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve është bërë një nga prioritetet më të larta politike të Bashkimit Evropian, shteteve anëtare të tij, dhe shteteve kandidatë dhe atyre me perspektivë që të bëhen kandidatë. Fëmijët kanë gjasa që të jenë në rrezik më të lartë nga varfëria sesa popullsia në përgjithësi. Në shumë shtete në tranzicion në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik, përkundër një periudhe të rritjes së qëndrueshme ekonomike, fëmijët në shumë raste janë ende në rrezik nga varfëria ekstreme. Kriza e tanishme ekonomike dhe financiare rrezikon bile edhe zhbërjen e përparimit që është arritur, në veçanti kur nuk ekzistojnë sistemet e forta dhe financiarisht të qëndrueshme të mbrojtjes sociale. Varfëria dhe përjashtimi i fëmijëve kanë kosto të larta individuale dhe sociale, ku fëmijët e rritur në varfëri janë në rrezik serioz për shëndetin, arsimim të ulët, pamundësinë për të gjetur punë më vonë gjatë jetës, dhe në përgjithësi humbjen e zgjedhjeve. Investimi në fëmijë prandaj është me rëndësi jo vetëm në kuptim të ngritjes së fëmijës jashtë varfërisë por gjithashtu është një mënyrë efikase dhe kosto efektive e sigurimit se brezat e tashëm të fëmijëve të bëhen qytetarë të rritur të shëndetshëm, produktiv dhe aktiv. Luftimi i varfërisë është i domosdoshëm për të luftuar përcjelljen e varfërisë në mes brezash, dhe për të siguruar se të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh rrethanat e tyre fillestare jetësore dhe prejardhjen sociale, gëzojnë mundësitë e barabarta në shoqëri. Një raport nga Këshilli i Francës për punësim, të ardhura dhe kohezion social, dërgon porosinë kyçe: “drejtësia sociale shkon krahas me efikasitetin kur thekson rëndësinë e luftës kundër varfërisë” (i cituar në Marlier et al, 2007; 10).

Bashkimi Evropian është duke udhëhequr rrugën në drejtimin e përpjekjes së përbashkët në luftimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve, duke njohur natyrën shumë dimensionale të problemit. Çështja e varfërisë së fëmijëve zë vend të lartë në agjendën e BE-së në vitin 2010, Viti Evropian për luftimin e varfërisë dhe përjashtimit social. Është nxjerrë mesimi se pa politika gjithëpërfshirëse për fëmijë dhe familje, varfëria e fëmijëve ka gjasa të ulëta që të reduktohet thjesht si rezultat i politikave të përgjithshme kundër varfërisë. Në vend se të parashkruhen modelet e politikave që i përshtaten të gjitha rrethanave për reduktimin e varfërisë së fëmijëve, Bashkimi Evropian tenton që të përforcojë bazën e dëshmive me qëllim që të përmirësojë kuptimin dhe lidhjen në mes të pakove të ndryshme të politikave dhe rezultateve në kuptim të mirëqenies së fëmijëve. Në ‘Metodën e hapur të bashkërendimit’, shtetet mund të mësojnë nga praktikat më të mira përmes “procesit të dyanshëm të komentimit të planifikimit, monitorimit,

ekzaminimit, krahasimit dhe përshtatjes së politikave kombëtare në bazë të objektivave të përbashkëta” (Marlier et al, 2007; 22).

Brenda shteteve anëtare të BE-së duket se janë tre faktorë kryesor që janë të ndërlidhur me varfërinë e fëmijëve: Fëmijët që jetojnë në ekonomitë familjare të papunë, fëmijët që jetojnë në ekonomitë familjare në rrezik të varfërisë duke qenë në punë, dhe fëmijët që jetojnë në shtetet anëtare me transfere të ulëta dhe/ose joefikase sociale. Politikat qeveritare, përfshirë sistemet tatimore dhe të beneficionit, janë thelbësore, ku Komisioni (2008) ka sugjeruar që:

1. *Shtetet anëtare që shpenzojnë për qindje të mëdha të BPV-së së tyre në mbrojtjen sociale (me përjashtim të pensioneve) kanë tendencë që të kenë norma më të ulëta të varfërisë së fëmijëve.*
2. *Beneficionet e shënjestruara veçanërisht të fëmijët kanë ndikim më të madh në varfërinë e fëmijëve.*
3. *Ofrimi i kujdesit për fëmijë të përballueshëm financiarisht mund të luaj një rol të rëndësishëm në përmirësimin e gjendjes së familjeve në tregun e punës.*

Në kontekstin e ‘Evropianizimit’ më të gjerë të politikave sociale, ekziston theksi në ngritje për prekjen e varfërisë dhe përjashtimit social në mesin e shteteve kandidatë nga të cilat kërkohet që të përgatisin raportin dhe të raportojnë për zbatimin e zotimeve në Memorandumin e përbashkët për gjithëpërfshirje sociale (MIP), dhe në shtetet me perspektivë të vendit kandidat që janë duke hartuar çdo ditë e më shumë strategji të stilit Evropian për të luftuar përjashtimin social. Ekziston pranimi në rritje se përveç përkufizimit të varfërisë në kuptim relativ, si 60% e të ardhurave mesatare, ekziston nevoja e matjes së varfërisë absolute dhe ekstreme si dhe të zhvillohet një pako e treguesve për brishtësinë materiale.

1.2. Kosova: Sfidat e mbrojtjes sociale

Kosova nën RSKB 1244 që shpalli pavarësinë e njëanshme në shkurt të vitit 2008, është një nga shtetet më të varfra në Evropë me BPV vjetore për kokë banori prej 1,726€ në vitin 2008 (Banka Qendrore e Kosovës, 2009). Rreth 32% e popullsisë së llogaritur të Kosovës prej 2.2 milion është nën moshën 15 vjeçare, me vetëm 6.5% të popullsisë mbi moshën 65 vjeçare. Kosova ka përjetuar rritje të dukshme ekonomike gjatë viteve të kaluara duke arritur 5.4% të BPV-së reale në vitin 2008, të nxitur nga ndihmat zhvillimore dhe dërgesat e parave nga punëtorët jashtë vendit. Kriza globale ekonomike ka gjasa që të reduktojë rritjen në nivelet në mes 3% dhe 4% në vitet 2009 e 2010 edhe pse këto mund të jenë parashikime optimiste nën dritën e rënies së IHD-së, dërgesave të parave dhe eksporteve (Toçi, 2010) dhe efektet e përhapjes në ekonomitë e vogla që ende nuk janë integruar plotësisht në tregjet globale. Papunësia e regjistruar ka mbetur stabile në rreth 338,000, gjatë vitit 2009 (BQK, 2009; 37), që paraqet mbi 40% të Kosovarëve që kërkojnë punë dhe që mund të punësohen (Mozaiku i Kosovës, 2009). Në tetor 2009, 47.6% e tyre ishin gra dhe 64% ishin të pakualifikuar (BQK, op. cit.), dhe siç raportohet, rreth 90% janë të papunë në afat të gjatë kohor (USAID/UNDP, 2009).

Vlerësimi i fundit e varfërisë nga Enti Statistikor i Kosovës/Banka Botërore, duke shfrytëzuar të dhënat nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2005/6 llogariti normën e përgjithshme të varfërisë (ato ekonomi familjare që shpenzojnë në ekuivalent të të rriturit prej më pak se 45€ në muaj) te 45% e popullsisë, dhe një ekstrem ose kufi të varfërisë në ushqim (më pak se 28€ në muaj) te 15% e popullsisë (Banka Botërore/ESK 2008). Fëmijët janë parë si një nga grupet veçanërisht në rrezik të lartë të varfërisë edhe pse nuk janë bërë kalkulimet detale. Gjatë dhe përtej varfërisë në të ardhura, normat e regjistrimit në arsim në Kosovë janë të ulëta në krahasim me standardet regjionale, në veçanti në nivelet parafillor, të mesëm dhe terciar (Banka Botërore 2007), duke shpenzuar 4.6% e BPV-së në arsim, në linjë me mesataret regjionale por që paraqesin një nivel të ulët të shpenzimeve publike në arsim për nxënës. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, që thuhet se janë grupet më të marginalizuara në Kosovë, kanë normat më të ulëta të regjistrimit në arsimin fillor në kontekst të heqjeve të shumta të të drejtave, përfshirë normat e larta të varfërisë (KFOS/COMPASS; 2009). Treguesit e shëndetit janë të dobët në përgjithësi, me normë të vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare më të lartën në Evropë, dhe nivele të larta të rritjes së penguar dhe të kequshqyerit në fëmijërinë e hershme (UNICEF, 2010). Kosova shpenzon rreth 3% të BPV-së në kujdes shëndetësor, dhe llogaritet se rreth 40% të krejt shpenzimeve në shëndetësi janë shpenzime private, duke rezultuar në pabarazi të dukshme në qasje, dhe pagesa nga xhepi të cilat kontribuojnë në varfëri (Stubbs dhe Haxhikadrija, 2008).

Korniza Kushtetuese e Kosovës është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe tani inkorporon referencën në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. UNICEF-i ka mbështetur emërimin e Këshilltarit për të drejtat e fëmijëve në Zyrën e Kryeministrit dhe ekipi për të Drejtat e Fëmijës është themeluar në Zyrën e Ombudspersonit. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është udhëheqëse në mbrojtjen sociale dhe gjithëpërfshirjen sociale dhe ka qenë pjesë e ekipit qeveritar që ka përgatitur Draftin e Letrës së Bardhë për politika sociale. Korniza afatmesme e shpenzimeve 2010-2012 ka vendosur 'Zbutjen e varfërisë dhe stabilitetin social' si një nga qëllimet gjithëpërfshirëse të qeverisë, së bashku me Rritjen Ekonomike, Zgjidhjen e Statusit dhe Qeverisjen e Mirë (Qeveria e Kosovës, 2009; 9). Që nga janari i vitit 2009 shërbimet sociale janë decentralizuar, duke shtruar rrugën për kombinim më të Evropianizuar të mirëqenies që lidhet me standardet e cilësisë, dhe përforsimin e rrjetit të ofruesve jo-shtetëror të shërbimit social të bazuar në komunitet, duke punuar në një sistem të standardeve të cilësisë.

Pavarësisht reformave në vazhdim e sipër, një raport i fundit për Komisionin Evropian ka konkluduar se "Kosova vuan nga një numër i problemeve në sistemin e saj të gjithëpërfshirjes sociale" (Stubbs dhe Haxhikadrija, 2008). Në mesin e atyre të nënvizuara ishin:

- *Mungesa e të dhënave të sakta për të bërë zgjedhjet e politikave në bazë të evidencës.*
- *Bashkëndimi i dobët horizontal dhe vertikal, përplasje në mes të*

qeverisjes teknike dhe politike, dhe mungesa e debatit publik dhe përfshirjes së akterëve në planifikim dhe menaxhim të shërbimeve.

- Ekzistojnë zotimet politike për barazinë gjinore, pakica dhe varfëri por nuk zbatohen ende si duhet.
- Politikat për fëmijët janë mungesë e madhe, pa marrë parasysh a lidhet me politikën e përgjithshme të fëmijërisë së hershme ose përgjigjes së koordinuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit të fëmijës.
- Përderisa reforma për pensionet, ndihmën shëndetësore dhe sociale duket se janë prioritete, asnjë nga to nuk janë formuluar në kuptim të implikimeve për fëmijët.
- Shumë pak shpenzohet në shërbimet sociale të bazuara në komunitet si pjesë e rrjetit të sigurisë sociale për mbrojtje dhe parandalim.
- Mungon strategjia e përgjithshme në kuptim të gjithëpërfshirjes sociale me një llojllojshmëri të ndikimeve të agjencive ndërkombëtare që ende tentojnë të dominojnë në pejsazhin e gjithëpërfshirjes sociale në Kosovë (ibid).

1.3. Ky studim

Ky dokument siguron një përmbledhje të raporteve të fundit, përfshirë një numër studimesh të mbështetura nga UNICEF-i në Kosovë për shtrirjen, natyrën, shkaqet dhe pasojat e varfërisë së fëmijëve në Kosovë. Ai në veçanti adreson rolin e transfereve sociale në reduktimin e niveleve të varfërisë së fëmijëve dhe eksploron një numër të opsioneve të politikave dhe të skenarëve. Opsionet e politikave janë paraqitur edhe në Dokumentin më të shkurtër me Opsione për Politika. Studimet më të rëndësishme që formojnë bazën e argumenteve të paraqitura këtu janë:

- *“Profili i varfërisë së fëmijëve dhe të rinjve në Kosovë”, i kryer nga HMO Solutions, nëntor 2008 (në tekstin e mëtejme HMO Solutions, 2008).*
- *“Varfëria e fëmijëve në Kosovë: Analizë e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2006/2007”, i kryer nga Yekatarina Chzhen nga Universiteti i Yorkut, Mbretëria e Bashkuar, Njësia për Hulumtime të Politikave Sociale (SPRU), dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme Chzhen, 2008).*
- *“Ndikimi i Skemës së beneficioneve të ndihmës sociale me para të gatshme për fëmijët në Kosovë”, i kryer nga Fraziska Gassman dhe Keetie Roelen të Universitetit në Maastricht, Holandë, korrik 2009 (në tekstin e mëtejme Gassman dhe Roelen, 2009).*

Përveç kësaj, Zyra Regjionale e UNICEF-it për EQL-SHPC ka nisur një program të madh për ‘Çfarë funksionon për reduktimin e varfërisë së fëmijëve’, duke kryer një sërë studimesh krahasuese përfshirë të mëposhtmen (që është ende në formë drafti) që i referohen direkt Kosovës dhe që është e rëndësishme së pamasë për këtë raport:

- *“Varfëria e fëmijëve në pesë shtete të EQL/SHPC”, i kryer nga Jonathan Bradshaw dhe Yekatarina Chzhen nga Universiteti i Yorkut, Mbretëria e Bashkuar, Njësia për Hulumtime të Politikave Sociale (SPRU), (në tekstin e mëtejme Bradshaw dhe Chzhen, 2010).*

Ky raport është pra një dokument për rishikim të politikave analitike që synon në politikë bërësit Kosovar dhe homologët dhe partnerët e tyre në komunitetin zhvillimor ndërkombëtar. Prandaj shumë nga çështjet teknike të diskutuara në raportet referente nuk janë adresuar gjerësisht këtu. Raporti synon që t'i kontribuojë debatit rreth mënyrës si të përmirësohet mirëqenia e fëmijës në Kosovë përmes ndikimit të politikave ekonomike dhe sociale që ndikojnë në ndarjen e resurseve, me qëllim që ta bëjnë reduktimin e varfërisë së fëmijëve prioritet në të ardhmen.



2

PROFILI I VARFËRISË
SË FËMIJËVE

NË KOSOVË

II. PROFILI I VARFËRISË SË FËMIJËVE NË KOSOVË

2.1. Norma e varfërisë së fëmijëve në Kosovë

Në bazë të të dhënave nga ABEF 2006/7, duke shfrytëzuar kufirin e varfërisë absolute të bazuar në konsum prej 1.417€ në ditë, dhe kufirin e varfërisë ekstreme/ushqimit prej 0.934€ në ditë si dhe një normë krahasuese ndërkombëtare prej 2.15 dollarë amerikan për ditë, fëmijët e moshës 0-19 vjeç janë në rrezik më të lartë të varfërisë sesa popullsia e përgjithshme në Kosovë. Ekonomitë familjare me fëmijë kanë gjasa më të mëdha për të qenë të varfër sesa ekonomitë familjare pa fëmijë, por pak më pak gjasa të varfërisë ekstreme (Chzhen, 2008 Tabela 1)².


Tabela1: Varfëria dhe varfëria e fëmijëve në Kosovë

	Popullsia e përgjithshme	Fëmijët	Ekonomitë familjare pa fëmijë	Ekonomitë familjare me fëmijë
Kufiri i varfërisë ekstreme/ushqimit	17.5%	18.9%	18.0%	17.3%
Kufiri i varfërisë absolute	46.2%	48.6%	38.3%	45.3%
2.15 \$ në ditë Kufiri i Varfërisë	62.3%	65.4%	49.4%	60.8%

Burimi: Chzhen (2008); Tabelat 1 dhe 2; 3.

Në krahasime ndërkombëtare Kosova ka norma të larta të varfërisë absolute në krahasim me fqinjët në Ballkanin Perëndimor (figura 1), edhe pse më të ulëta sesa ish shtetet e Bashkimit Sovjetik në Azinë Qendrore dhe në Kaukaz (tabela 2).

Figura 1. Normat e varfërisë në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Gueorguieva 2007. Kufijtë e varfërisë në bazë të konsumit kombëtar nga vlerësimet e varfërisë nga Banka Botërore. Shënime: Periudha fillestare: Shqipëria (2002), Bosnje dhe Hercegovina (2001), IRJM (2002), Kosova (2003), Mali i Zi (2005), Serbia (2004), vitet e fundit: Shqipëria (2005), Bosnje dhe Hercegovina (2004), IRJM (2004), Kosova (2005), Mali i Zi (2006), Serbia (2006)

² Duke shfrytëzuar pakon e njëjtë të të dhënave, Gassman dhe Roelen (2009) prodhojnë norma paksa të ndryshme, por në marrëveshje të përgjithshme me Chzhen (2008) në kuptim të dallimeve në normat e varfërisë së fëmijëve dhe atë të përgjithshme.


Tabela 2: Krahasimet e normave të varfërisë së fëmijëve

	2 x kufiri i varfërisë në ushqim	4 x kufiri i varfërisë në ushqim
Armenia	12.1%	68.6%
Bosnja dhe Hercegovina	0.6%	7.7%
Gjeorgjia	21.2%	60.2%
Kosova	10.9%	50.5%
Serbia	1.5%	13.3%

Burimi: Bradshaw dhe Chzhen (2010) Tabela 1

Studimi i fundit i Bankës Botërore bën krahasimet regjionale duke shfrytëzuar normat e varfërisë prej 2.50 dhe 5.00 PPP dollarë amerikan. Siç tregon figura 2 më poshtë, Kosova ka norma të larta të varfërisë bile edhe në kontekst krahasues të regjionit më të gjerë, e radhitur e 22-ta nga 25 shtete në të dyja nivelet e varfërisë.

Figura 2. Numërimi bazë i varfërisë për kohë banori në EQL-SHPC



Burimi: Banka Botërore (2010). Duke shfrytëzuar vitin e fundit për të cilin të dhënat janë në dispozicion

Në kuptim të karakteristikave të ndërlidhura me rrezikun më të lartë të varfërisë së fëmijëve, këtu të përkufizuar si kufiri i 1.417€ në ditë, më poshtë janë pjesët më të rëndësishme të studimit të Chzhen (shih rezultatin e plotë në tabelën 4):

- *Ekonomitë familjare me tre fëmijë kanë normë të varfërisë së fëmijëve prej 53% dhe ato me katër e më shumë fëmijë kanë normë të varfërisë së fëmijëve prej 52.6%, që janë dukshëm më të larta sesa ekonomitë familjare me një fëmijë (34%) ose dy fëmijë (39,9%). Në përgjithësi 77,7% e të gjithë fëmijëve të varfër jetojnë në ekonomi familjare me tre ose më shumë fëmijë, në krahasim me 71,5% e fëmijëve në popullsinë e përgjithshme.*
- *Me rreziqet më të larta të varfërisë përballen fëmijët e moshës 0-5 (49.7%) dhe 6-14 (48.7%), me rrezik më të ulët për ata të moshës 15-18 (41.7%). Në përgjithësi 93.6% të fëmijëve të varfër janë të moshës 0-14, me 92.4% e të gjithë fëmijëve në Kosovë të këtij grupi të moshës.*
- *Rreziku më i lartë i varfërisë së fëmijëve është për ata fëmijë ku të ardhurat kryesore të ekonomisë familjare janë nga ndihma sociale (94,8%), që përbëjnë 16,5% e fëmijëve të varfër dhe 8,5% e të gjithë fëmijëve në Kosovë. Me rrezik dukshëm më të madh të varfërisë së fëmijëve përballen ata fëmijë në të cilat kryefamiljari merr pension (67,2%) ose kur ata paguhet në bazë ditore (66,5%). Përderisa në përgjithësi ata që kanë norma më të ulëta mesatare të varfërisë së fëmijëve, fëmijët në ekonomi familjare që marrin të ardhura përbëjnë 36% të të gjithë fëmijëve në varfëri në Kosovë. Megjithatë jeta në ekonomi familjare me një (42.7%) dy ose me më shumë (40.9%) të moshuar mbi moshën 65 vjeçare redukton rrezikun e varfërisë (51.7% të fëmijëve ekonomive familjare pa asnjë të moshuar të moshës 65 vjeçare janë në rrezik).*
- *Në kuptim të aktivitetit kryesor të kryefamiljarit, varfëria e fëmijës është e lartë ku kryefamiljari është i papunësuar (65,2), ose paguhet në baza ditore (66,2%).*
- *Përderisa përbëjnë vetëm 3,4% të fëmijëve të Kosovës, fëmijët kryesisht rom, ashkali dhe egjiptian, e jo shqiptar e serbë, janë në rrezik për normë të lartë të varfërisë (60,5%).*
- *Ekonomitë familjare pa arsim të kryer përballen me rreziqe të larta të varfërisë së fëmijës (58,7%), dhe 20,8% e fëmijëve të varfërve dhe 17,3% e të gjithë fëmijëve jetojnë në ekonomitë e tilla familjare.*

Tabela 4: Normat e varfërisë, dallimi dhe përbërja për nga lloji i ekonomisë familjare (2006/7)

	Norma e varfërisë së fëmijës (ushqim) (1)	Norma e varfërisë së fëmijës (gjithsej) (2)	Dallimi mesatar i varfërisë (total) (3)	Përbërja e varfërisë (4)	Gjendja e të gjithë fëmijëve (5)
Numri i fëmijëve nën moshën 19 vjeçare					
Një	11.5*	34.0**	28.0	5.5	7.9
Dy	14.1*	39.9**	29.5	16.9	20.5
Tre	21.8*	53.0**	31.5	28.3	25.9
Katër ose më shumë	20.7*	52.6**	30.4	49.4	45.6
Mosha e fëmijës më të vogël					
0-5	18.4	49.7	29.7	51.8	50.7
6-14	20.8	48.7	32.2	41.8	41.7
15-18	11.3	41.7	24.9	6.5	7.6
Numri i të rriturve (të moshës 19 e mbi)					
Një/dy	22.9	52.8	33.5	31.0	28.6
Tre	20.8	45.0	34.3	16.2	17.5
Katër	14.4	45.6	27.1	18.1	19.3
Pesë e më shumë	17.1	48.7	27.7	34.7	34.6
Numri i të moshuarve (të moshës 65 e mbi)					
Asnjë	19.2	51.7*	30.6	72.4	68.2
Një	19.2	42.7*	31.2	20.5	23.4
Dy e më shumë	15.8	40.9*	26.9	7.1	8.5
Burimi kryesor i të ardhurave nga ekonomia familjare					
Pagat nga punësimi publik	13.5***	37.0***	29.3	18.8	24.8
Pagat nga punësimi privat	10.2***	43.4***	24.0	17.2	19.2
Bujqësia	16.0***	48.6***	28.7	9.2	9.2
Pagesat ditore	19.7***	66.5***	27.5	16.1	11.8
Biznes tjetër i ekonomisë familjare	8.3***	26.1***	25.7	5.4	10.0
Pensionet	33.2***	67.2***	30.5	7.3	5.3
Dërgesat e parave nga jashtë	10.1***	38.3***	23.2	7.8	9.9
Dërgesat tjera të parave	[-]	[-]	[-]	1.5	1.0
Ndihma Sociale	69.3***	94.8***	46.7	16.5	8.5
Tjetër	[-]	[-]	[-]	0.3	0.4
Aktiviteti kryesor i kryefamiljarit					
Punësimi me pagë	10.6***	35.2***	26.7	20.8	28.8
Bujqësia	15.4***	48.5***	26.9	10.5	10.6
Puna ditore	21.7***	66.2***	30.2	13.6	10.0
Vetëpunësimi	6.6***	21.9***	29.1	3.3	7.4
I pensionuar/paafte	18.9***	52.8***	26.4	27.0	24.9
I papunë/tjetër	37.2***	65.2***	39.8	24.8	18.5
Gjinia e kryefamiljarit					
Mashkull	18.6	48.9	30.1	96.3	95.8
Femër	24.9	43.1	39.6	3.7	4.2
Kombësia e kryefamiljarit					
Shqiptar	18.5	48.5	30.0	93.1	93.4
Serb	18.0	40.5	35.3	2.6	3.2
Tjetër	30.5	60.5	38.2	4.2	3.4
Niveli më i lartë i arsimit të kryefamiljarit					
Asnjë	22.3*	58.7***	29.8	20.8	17.3
Fillor	21.0*	53.8***	31.3	31.4	28.4
Mesëm	18.7*	46.5***	30.8	41.5	43.5
Profesional/tjetër	8.8*	28.0***	26.1	6.3	10.9
Regjioni					
Gjakovë	19.5***	52.4***	29.2	14.6	13.5
Gjilan	3.8***	15.8***	24.6	3.7	11.3
Mitrovicë	30.5***	60.7***	34.5	21.4	17.2
Pejë	21.5***	44.4***	33.8	9.7	10.6
Prizren	9.3***	42.4***	23.0	14.3	16.4
Prishtinë	14.9***	49.9***	27.2	21.4	20.8
Ferizaj	36.1***	71.7***	36.7	15.1	10.2
Fusha sipas kombësisë					
Shqiptar	18.9	48.8	30.3	97.1	96.7
Serb	19.4	42.6	35.3	2.9	3.3
Zona					
Urban	18.8	45.0	32.9	29.0	31.3
Rural	18.9	50.3	29.4	71.0	68.7
Të gjithë (të përpunuar N=1,730)	18.9	48.6	30.4	100	100

Burimi: Chzhen (2008); Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

Përlllogaritjet janë plotësisht të ponderuara sipas dizajnit kompleks të anketës. Rëndësia statistikore:

*=p<0.05, **=p<0.01, ***=p<0.001 (tabulimet e ndara kryqëzore me testet chi-katror).

[-] përpjestimet e ponderuara janë bazuar në më pak se 20 raste të përpunuar

Ekziston dallimi i madh regional në normat e varfërisë së fëmijës nga 72% në Ferizaj në 16% në Gjilan, dhe bile më i madh në kuptim të komunave që ndryshojnë nga 4% në Kamenicë gjer në 92% në Kaçanik, por nuk ka dallime të mëdha në mes të normave në viset urbane dhe rurale. Kur kontrollohen karakteristikat e ekonomisë familjare atëherë shumica e pikëve të përgjithshme të përmendura më sipër janë të vërteta. Megjithatë, fëmijët në ekonomitë familjare me kryefamiljar femër kanë gjasa shumë më të vogla për të qenë të varfër sesa në ekonomitë familjare me kryefamiljar mashkull. Ekonomitë e tilla familjare janë të pakta në numër në Kosovë, me vetëm 4% të fëmijëve kosovar që jetojnë në ekonomitë e tilla familjare, të cilat, ndoshta jo befas, kanë nivel të lartë të përkrahjes me dërgesa të parave nga jashtë. Përveç kësaj, fëmijët në viset me shumicë serbe kanë gjasa shumë më të mëdha për të qenë të varfër sesa fëmijët në viset shqiptare kur shikohen karakteristikat e ekonomisë familjare. Këto modele të përgjithshme janë të vërteta në studimet tjera që shfrytëzojnë kufijtë e ndryshëm të varfërisë edhe pse studimi nga Gassmann dhe Roelen (2009) ka gjetur norma më të ulëta të varfërisë së fëmijës te fëmijët e origjinës serbe, dhe studimi nga Gassmann dhe Roelen (2010) konstatoi norma më të larta të varfërisë së fëmijëve në ekonomitë familjare me kryefamiljar femër.

2.2. Fëmijët dhe brishtësia materiale dhe e strehimit

Siç mund të shihet nga tabelat më poshtë, fëmijët e varfër dhe fëmijët tepër të varfër kanë gjasa që të jetojnë në ekonomi familjare ku mungon komoditeti shtëpiak dhe të mirat afatgjate në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që nuk janë të varfër (tabela 5 dhe 6). Dallimet janë edhe më të qarta kur ndërtohen treguesit e prevalencës së brishtësisë. Përderisa treguesit e prevalencës së brishtësisë janë paksa teknik në natyrë, japin më shumë peshë masës së brishtësisë në lidhje me artikujt që shumica e popullsisë tanimë i kanë, duke bërë më akut nivelin e brishtësisë së atyre të cilëve u mungojnë ato. Ky koncept i matjes është se niveli i brishtësisë relative për një individ ngritët për aq sa më e madhe të jetë pjesa e popullsisë që 'ka' atë artikull që i mungon individëve në fjalë. Tabelat 7 dhe 8 përcaktojnë treguesit e matur të brishtësisë për të gjithë fëmijët, dhe tregojnë se të varfrit dhe tepër të varfrit përballen me nivele më të larta të brishtësisë materiale dhe strehimit. Fëmijët e varfër kanë gjasa më të mëdha që të jetojnë në hapësira të tejmbushura me persona, me numër mesatar të dhomave për person prej 0,55 për të gjithë fëmijët, 0,49 për fëmijët e varfër dhe 0,46 për fëmijët tepër të varfër. Vërehet nga studimi i Gassmann dhe Roelen (2010) se fëmijët në Kosovë jetojnë në hapësira të tejmbushura me persona në kuptim të numrit mesatar të dhomave për person sesa bashkëmoshatarët e tyre në 5 shtetet tjera (tabela 9). Kur merren parasysh së bashku varfëria në konsum, brishtësia e strehimit dhe jeta në mjedise të tejmbushura me persona, 76,4% e fëmijëve janë të varfër ose të brishtë në së paku një dimension, 42,8% në dy dimensione, dhe 12,8% në të gjitha tri dimensionet (Chzhen, 2008; 15).

Tabela 5: Mungesa e të mirave afatgjate (2006)

	% e të gjithë fëmijëve	% e fëmijëve të varfër	% e fëmijëve tepër të varfër
Televizori	4.2	5.8	8.4
Frigoriferi	15.1	21.7	29.8
Hekuri për hekurosje	18.1	24.9	38.1
Thithëse elektrike	23.8	33.8	45.3
Telefoni celular	24.4	35.9	48.1
Makina larëse	25.6	39.3	50.3
Vetura	40.5	56.7	73.0
Gjeneratori	86.2	94.5	95.3
Kompjuteri	89.7	97.4	97.5

Burimi: Chzhen (2008); Tabela 5, përlllogaritja nga të dhënat e ABEF 2006

Tabela 6: Mungon komoditeti shtëpiak (2006/7)

	% e të gjithë fëmijëve	% e fëmijëve të varfër	% e fëmijëve tepër të varfër
Rryma elektrike	1.2	1.9	1.9
Muret e bllokut, tullave ose çimentos	3.8	3.4	5.5
Dëme të mëdha	7.4	9.1	12.1
Çezme të brendshme	13.5	20.4	27.4
Tualete	15.9	23.0	33.3
Kuzhinë	19.7	27.9	38.1
Banjë	23.2	30.0	36.1
Lidhje telefoni	68.8	75.8	81.3
Ngrohje qendrore	94.8	97.2	98.4

Burimi: Chzhen (2008); Tabela 8, përlllogaritja nga të dhënat e ABEF 2006-2007

Tabela 7: Prevalenca mesatare e brishtësisë e ponderuar dhe normat e brishtësisë

	Të gjithë fëmijët	Fëmijët e varfër	Fëmijët tepër të varfër
Mesatarja (SD)	14.71 (0.59)	20.35 (0.82)	26.57 (1.36)
Norma e brishtësisë (%)	52.9	69.9	75.8

Burimi: Chzhen (2008); Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006

Tabela 8: Prevalenca mesatare e brishtësisë shtëpiake së ponderuar dhe normat e brishtësisë shtëpiake

	Të gjithë fëmijët	Fëmijët e varfër	Fëmijët tepër të varfër
Mesatarja (SD)	10.77 (0.55)	13.84 (0.83)	17.64 (1.28)
Norma e brishtësisë (%)	38.5	46.8	58.0

Burimi: Chzhen (2008); Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

Tabela 9: Numri mesatar i dhomave për person

	Të gjithë	Fëmijët e varfër (4x kufiri i ushqimit)	Fëmijët e varfër (2x kufiri i ushqimit)
Armenia	0.60	0.56	0.58
Bosnja dhe Hercegovina	0.81	0.64	0.50
Gjeorgjia	0.68	0.65	0.62
Kosova	0.55	0.51	0.47
Kirgistani	0.69	0.68	0.60
Serbia	0.70	0.31	0.49

Burimi: Bradshaw dhe Chzhen (2010) Tabela 13 f 13



3

ROLI I TRANSFEREVE
SOCIALE DHE
HAPËSIRA FISKALE

III. ROLI I TRANSFEREVE SOCIALE DHE HAPËSIRA FISKALE

3.1. Transferet e parave të gatshme

Kosova nuk ka skemë të beneficionit për të papunët, nuk ka shtesa të amësisë dhe nuk ka skemë të beneficionit për fëmijët. Ajo ka skemën e pensionit social, skemën për invalidët e luftës dhe familjet e të rënëve gjatë luftës, dhe skemën e pensionit invalidor. Përveç kësaj, Kosova ka paraqitur një skemë të re në vitin 2009 që shënjestronte familjet që kujdesen për fëmijët me paaftësi të rënda dhe të përhershme. Hëpërhë nga kjo skemë përfitojnë 2,158 përfitues të cilët pranojnë nga 100€ në muaj. Ndoshta është e diskutueshme se sa efektive transferet e tilla pasive të parave të gatshme janë në kontekst të gjendjes ku Kosova shpenzon shumë pak në shërbimet e bazuara në komunitet. Përveç kësaj, skema për invalidët e luftës mbulon katër grupe të ndryshme të përfituesve: Invalidët si rezultat i aktivitetit ushtarak, viktimat civile të luftës dhe familjet e luftëtarëve të rënë (termi 'dëshmorët e luftës' në Ligj), familjet e personave të pagjetur, dhe kujdestarët e invalidëve të luftës. Skema është prioritet i kushtueshëm politik që mund të thuhet se çrregullon shifrat që shpenzohen për mbrojtje sociale dhe rezulton në pak resurse në dispozicion për grupet tjera të brishta, përfshirë fëmijët.

3.2. Ndikimi i transfereve sociale në varfërinë e fëmijëve

ABEF 2006/7 ka regjistruar 32% të fëmijëve që kanë së paku një familjar që pranon 'beneficionet për mirëqenie sociale', që paraqet mesatarisht të ardhurat mujore prej 53,23 € në muaj. Nëse beneficionet zbriten nga shpenzimet totale të ekonomisë familjare (dhe pasi të kalkulohet inflacioni prej qershorit 2002 dhe barazohet duke shfrytëzuar shkallën ekuivalente për të rriturit), norma e varfërisë ekstreme është 3,7 dhe norma e varfërisë totale është 4.3 pikë përqindje më e lartë (tabela 10). Kjo tregon se të ardhurat nga beneficionet e mirëqenies sociale mund të jenë të rëndësishme për ngritjen e fëmijëve përmbi pragjet e varfërisë, duke supozuar se i kontribuon standardeve të përgjithshme jetësore të ekonomisë familjare. Nëse beneficionet për mirëqenie zbriten nga konsumi i tyre i përgjithshëm i ekonomive familjare, 5% e fëmijëve që aktualisht nuk janë të varfër në bazë të kufirit të varfërisë ekstreme do të klasifikoheshin në varfërinë ekstreme. Njëkohësisht 9% e fëmijëve që aktualisht nuk janë të varfër në bazë të kufirit total të varfërisë janë klasifikuar si të varfër nëse të ardhurat nga beneficionet zbriten nga konsumi i ekonomisë familjare. Për dallim, të ardhurat nga pensioni (që mund të jetë nën-raportuar në ABEF) bëjnë pak dallim në normat mesatare të varfërisë së fëmijëve në bazë të konsumit. Nëse pensionet zbriten nga shpenzimet totale të ekonomisë familjare, norma e varfërisë ekstreme është vetëm 0,7 dhe norma totale e varfërisë është 0,1 për qind më e lartë. Më pak se 1% e fëmijëve që aktualisht nuk janë të varfër në bazë të kufirit total të varfërisë do të klasifikoheshin si të varfër nëse të ardhurat nga beneficionet zbriten nga konsumi i ekonomisë familjare.

Tabela 10: Normat e varfërisë së fëmijëve me dhe pa beneficione të mirëqenies sociale (2006/2007)

Pragu	Norma e varfërisë së fëmijës (%)	
	Me beneficione	Pa beneficione
Kufiri i varfërisë ekstreme	18.9	22.6
Kufiri i varfërisë totale	48.6	52.9

Burimi: Chzhen (2008); tabela 16, 17. Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

Duke shfrytëzuar kufirin prej 2x dhe 4x të kufirit të varfërisë në ushqim, ndikimit të beneficioneve të mirëqenies sociale gjithashtu i është dhënë rëndësi në studimin Bradshaw dhe Chzhen (2010). Pa këto beneficione 16,7% në krahasim me 10,9% të fëmijëve do të ishin në varfëri nën kufirin e poshtëm, dhe 53,9% në krahasim me 50,5% në kufirin e sipërm. Këto beneficione bëjnë dallim të konsiderueshëm me 56% të fëmijëve të nxjerrë nga varfëria duke shfrytëzuar kufirin e poshtë dhe 37% kufirin e sipërm. Për dallim me studimin e Chzhen (2008), pensionet gjithashtu bëjnë dallim, duke nxjerrë 12,7% dhe 21,3% të fëmijëve nga varfëria, respektivisht.

3.3. Skema e ndihmës sociale

Skema e ndihmës sociale në Kosovë është mekanizmi kryesor për sigurimin e transfereve të parave të gatshme për ekonomitë familjare të varfra. Sa i përket qëllimeve dhe synimeve, skema është version i rishikuar i një versioni të paraqitur në vitin 2000, e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin për Skemën për Ndhimën Sociale në vitin 2003 (Ligji nr. 2003/13). Hëpërhë ekzistojnë dy lloje të ndihmës sociale:

Kategoria I: i jepet ekonomive familjare ku të gjithë anëtarët janë të varur. Kjo përfshinë të rritur me paaftësi të rënda ose të përhershme, ata mbi moshën 65 vjeçare, ata që kujdesen për një person të vjetër ose të paaftë ose fëmijë nën moshën 5 vjeçare, fëmijët gjer në moshën 14 vjeçare, fëmijët në mes të moshës 15-18 vjeçare në arsim të plotë, dhe prindërit e vetëm me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeçare.

Kategoria II: i jepet ekonomive familjare ku një familjar është i aftë që të punojë por është i papunë dhe së paku një fëmijë nën moshën 5 vjeçare ose jetim nën moshën 15 vjeçare nën kujdes të plotë. Në një mënyrë ndihma sociale e kategorisë së dytë funksionon si një lloj i kombinimit të përafrimit minimal të beneficionit për papunësi dhe beneficionit për fëmijë ku asnjëra prej tyre nuk ekziston si skemë e beneficionit të parave të gatshme në Kosovë.

Skemat janë të bazuara në testim të kombinuar të aseteve dhe të hyrave, me posedime të caktuara që automatikisht diskualifikojnë ekonominë familjare. Përderisa skema kombëtare e ndihmës sociale administrohet nga Qendrat për Punë Sociale ku nivelet e beneficionit kalkulohen duke zbritur të ardhurat e njohura të ekonomisë familjare nga norma bruto standarde. Pasi që mbeti konstante për 6 vite, norma bruto standarde, që paraqet beneficionin maksimal të ndihmës sociale për një familje pa të ardhura të llogaritura, është ngritur për 5€ që është në fuqi prej 1 janarit të vitit 2009 dhe tani është 40€ për ekonomitë familjare me një anëtar, 55€ për ekonomitë familjare me dy anëtarë, 60€ për ekonomitë familjare me tre anëtarë që ngritët për 5€ për çdo anëtar shtesë të familjes gjer

në maksimum 75€ për ekonomitë familjare me gjashtë ose më shumë anëtarë³. Numri i përfituesve, beneficiari mesatar dhe kostoja e skemës është treguar në tabelën 11 më poshtë. Tabela 12 tregon përpjesëtimin e shfrytëzuesve të kategorisë 1 dhe kategorisë 2 në dhjetor 2008, duke treguar dallimet e shënuara regjionale në përpjesëtime dhe gjithashtu faktin se përderisa më shumë ekonomi familjare kërkojnë ndihmën nga kategoria 1, janë dukshëm më shumë përfitues të mbuluar nga ndihma e kategorisë 2.

Tabela 11: Skema e ndihmës sociale në Kosovë: Përfituesit, beneficionet dhe kostoja (muaji dhjetor)

	XII/2005	XII/2006	XII/2007	XII/2008	XII/2009
Numri i familjeve	42,052	40,563	37,170	34,307	35,654
Nr i individëve	178,121	174,131	161,049	149,227	152,508
Mesatarja mujore për familje në €	60.99	60.73	61.06	61.26	65.91
Mesatarja mujore për person në €	14.40	14.15	14.09	14.08	15.40
Kostoja mujore në miliona €	2.565	2.464	2.270	2.102	2.350

Burimi: Gassmann dhe Roelen (2009); 25 dhe të dhënat administrative nga MPMS

Tabela 12: Numri i përfituesve të ndihmës sociale për kategori në dhjetor 2008.

Regjioni	Kategoria	Familjet	Anëtarë të familjes	Përpjesëtimi i përfituesve të NS	Shuma (€)
Prishtinë	1	4120	15.725	37,4	243.756,00 €
	2	5046	26.276	62,6	333.752,00 €
		9166	42.001		
Gjilan	1	2350	8.188	35,0	133.962,00 €
	2	3018	15.184	65,0	196.015,00 €
		5368	23372		
Pejë	1	3024	11.508	42,6	175.771,00 €
	2	2964	15.517	57,4	195.058,00 €
		5988	27025		
Prizren	1	2018	7.193	38,7	113.773,00 €
	2	2088	11.379	61,3	138.664,00 €
		4106	18572		
Mitrovicë	1	5876	19.715	51,5	326.567,00 €
	2	3803	18.542	48,5	244.466,00 €
		9679	38257		
Gjithsej për nga kategoria	1	17.388	62.329	41,8	993.829,00 €
	2	16.919	86.898	58,2	1.107.955,00 €
Total		34.307	149.227		2.101.784,00 €

Burimi: Gassman and Roelen (2009) të dhënat administrative të siguruar nga MPMS



3 Gjer më 1 janar 2009, ekonomitë familjare me 6 persona kanë pranuar më së shumti 70€ dhe ato me 7 ose më shumë anëtarë kanë pranuar 75€.

Disa përparësi dhe dobësi të skemës së ndihmës sociale, të vërejtura në disa studime janë si vijon:

- *Skema është shumë mirë e shënjestruar ku Gueorguieva (2007) ka vërejtur se 78,1% e fondeve i shkon të varfërve, përfshirë 49,2% për kuintalin më të varfër. Ky është një nga rezultatet më të mira në kuptim të ndihmave të shënjestruara sociale në Evropën Juglindore.*
- *Njëkohësisht mbulimi i skemës është mjaft i kufizuar që mbulon vetëm 23% të të varfërve. Me fjalë tjera, rreth 695,000 të varfër në Kosovë nuk pranojnë beneficione të ndihmës sociale.*
- *Siç u tha më sipër, skema është mjaft e kufizuar në kuptim të përshtatshmërisë, edhe me ngritjen e fundit të normës bazë. Përderisa norma për një person është 40€ dhe është afër kufirit të varfërisë prej 45€ në muaj, shtimi i 5€ për çdo anëtar shtesë është shumë i vogël dhe nuk bart kurrfarë marrëdhënie me kostot e konsumit që shfaqen nga anëtarët shtesë të ekonomisë familjare që jetojnë në varfëri, që në përgjithësi konsiderohet se është në mes 30% dhe 75% të normës bazë në shtetet me të ardhura të mesme/ulëta.*

Në kuptim të kostos së skemës, Gueorguieva ka llogaritur se skema paraqet 1.3% të BPV-së, ngjashëm si në Maqedoni por më e lartë se në shumë fqinjë të Evropës Juglindore që kanë pranuar se shpenzojnë shumë pak në ndihma sociale. Këto shifra duhet të trajtohen me kujdes pasi që ajo çka përfshihet në çdo shtet ndryshon dhe nuk ka metodologji standarde për qëllime krahasimi për përdorim në regjion. Gassmann dhe Roelen kalkulojnë se shpenzimet vjetore për ndihmë sociale janë pak mbi 26 milion € që paraqitet vetëm me 18.3% e shpenzimeve të krejt beneficioneve të mirëqenies sociale në vitin 2008, që është rreth 1 milion € më pak sesa që është buxhetuar dhe është duke rënë nga 24% në vitin 2007 dhe më e larta prej 35% në vitin 2004 (tabela 13a). Për dallim pensionet e pleqërisë përbëjnë 46% e shpenzimeve në vitin 2008, dhe pensionet në përgjithësi mbi 56% e të gjitha shpenzimeve (figura 13b).

Figura 2. Krahasimet regionale




Burimi: Gueorguieva, A. (2008)

Tabela 13 a. Buxheti vjetor dhe shpenzimet aktuale për lojet e ndryshme të beneficioneve të mirëqenies sociale në Euro 2004 – 2008
Burimi: Gassmann dhe Roelen (2009) tabela 11 f.26. Të dhënat administrative të siguruar nga MEF

	2004		2005		2006		2007		2008	
	Buxheti	Shpenzimet aktuale	Buxheti	Shpenzimet aktuale	Buxheti	Shpenzimet aktuale	Buxheti	Shpenzimet aktuale	Buxheti	Shpenzimet aktuale
Lloji i mirëqenies sociale										
Pensionet bazë – pleqërisë	51.998.165	50.605.099	62.512.000	60.395.021	64.287.926	64.279.287	63.282.000	63.196.695	65.746.920	65.630.259
Pensionet bazë – që lidhen me punë					139.150	121.097	100.000	99.600	100.000	99.874
Pensionet e Trepçës	1.589.280	1.260.000	2.820.000	2.500.179	2.955.390	2.953.720	2.865.760	2.818.480	2.803.760	2.775.750
Veteranët e luftës/ beneficionet për invalidët	4.560.000	4.377.434	7.200.000	4.468.181	4.971.564	4.845.752	8.828.480	8.770.832	19.792.480	18.417.154
Beneficionet për rrymë elektrike			12.700.000	12.700.000			4.500.000	4.500.000	4.500.000	4.500.000
Pagesa për libra shkollorë					200.000	199.996	350.000	349.995	2.391.198	1.225.781
Beneficionet për kujdesin në familje							198.000	77.684	2.375.181	892.193
Ndihmë sociale – transfere të parave	35.150.000	32.337.878	28.888.000	31.248.337	30.232.235	30.195.678	29.990.000	28.017.565	27.028.000	26.065.990
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara	9.952.000	4.763.970	13.900.000	14.619.447	14.907.230	14.795.369	13.192.000	10.092.562	10.250.080	10.016.528
Shërbimet sociale							850.000	689.807	160.000	825.915
Instituti i shërbimeve sociale							30.000	28.160	30.000	28.200
Pensionet për pleqë që kanë punuar (75€)									12.285.609	11.289.103
total	103.249.445	93.344.381	128.020.000	125.931.165	117.693.495	117.390.899	124.186.240	118.641.379	147.463.228	141.766.746
% e pjesës së ndihmës sociale	34	35	23	25	26	26	24	24	18	18

Figura 13b. Shpenzimet e tanishme si përqindje e totalit, 2008.



NB: Të tjerat përfshijnë shërbimet sociale, beneficionet për kujdesin në familje, beneficionet për rrymë elektrike, pensionet përfshijnë pensionet e pleqërisë dhe që lidhen me punë, pensionet e Treççës dhe pensionet për të moshuarit me regjistër të dëshmuar të përvojës së punës.


3.4. Hapësira fiskale dhe drejtimi strategjik

KASH për 2010-2012 tregon hapësirë të kufizuar fiskale në dispozicion në Kosovë. Në vitin 2009 shpenzimet (në 1,094 milion €) tejkaluan të ardhurat (prej 956 milion €) për 137 milion €. Përmes kufizimit të shpenzimeve dhe rritjes së të ardhurave, KASH ka një cak ambicioz të të ardhurave dhe shpenzimeve që barazohen në 1,133 milion € gjer në vitin 2012, në bazë të parashikimeve ambicioze të rritjes në kontekst të krizës globale ekonomike dhe fiskale. KASH vëren se në vitin 2009, subvencionet dhe transferimet u ngritën për rreth 10 milion € në 219,8 milion € por ato priten që të bien për 12 miliona € në vitin 2010 dhe për 10,4 miliona € në vitin 2011, me vetëm ngritje të vogël prej 4,2 miliona € për vitin 2012. Kjo tregon se hapësira fiskale për shpenzimet e reja sociale është e kufizuar, së paku për afat të shkurtër gjer të mesëm. Megjithatë një nga objektivat kryesore brenda KASH është "përmirësimi i mirëqenies dhe mbështetjes për familjet përmes sigurimit të ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e cenuara" (Qeveria e Kosovës, 2009; 103). Brenda kësaj, ideja e indeksimit të beneficioneve nga Skema e Ndihmës Sociale është një nga aktivitetet kryesore të parapara (shih më poshtë).

KASH gjithashtu bën referencë në draft Letrën e Bardhë për politika sociale që është hartuar nga një Grup Punues përfshirë përfaqësuesit nga MPMS dhe MEF por që ende nuk është finalizuar e as nuk ka marrë miratimin nga Parlamenti. Megjithatë ajo paraqet një deklaratë të përgjithshme për drejtimit e përgjithshme strategjike të Qeverisë në lidhje me mirëqenien sociale. Në kuptim të Ndihmës Sociale, ajo flet për një ngritje të indeksuar për të mbuluar inflacionin në mes të viteve 2005 dhe 2008 prej 27,35%. Kjo do të ngritë koston e përgjithshme të skemës nga 27,5 milion €, kur është bërë ngritja aktuale prej 5 € në janar 2009, në 32.2 milion €, ose ngritje efektive prej 17.4%. Propozimi i dytë përfshinë dy ndryshime: së pari, 5€ shtesë për të gjithë fëmijët e moshës 6-18 vjeçare në arsim të rregullt, dhe ngritje 5€ për person për anëtarin e dytë dhe secilin anëtar shtesë të ekonomisë familjare, duke shtuar koston vjetore të skemës në rreth 35,6 milion €. Këto propozime ishin përfshirë në draftin e rishikuar të Ligjit për Ndihmën Sociale që është miratuar nga Qeveria por është kthyer nga Parlamenti, fillimisht në bazë të implikimeve të koston.

Siç tregon një KASH më i hershëm (për 2008-2011), shpenzimet për mbrojtje sociale ranë në vitin 2007 në krahasim me vitin 2006 por ende përbëjnë pjesë substanciale të shpenzimeve publike, që janë shumë më të larta se mbrojtja, për shembull. Kjo sugjeron se buxheti për fëmijë i shpërndarë përgjatë buxheteve për shëndetësi, arsim dhe mbrojtje sociale, mund të përballohet më së miri duke ndryshuar strukturën e shpenzimeve dhe/ose përmirësimin e efikasitetit të shpenzimit në vend të riorientimit të resurseve nga sektorët tjerë. Kërkesat relative për buxhet për fëmijët në krahasim, të themi me veteranët e luftës dhe pensionistët, gjithashtu mund të kërkojnë adresim.

Figura 14: Përbërja e shpenzimeve për nga funksioni i Qeverisë 2005-7



Burimi: KASH 2008-11

3.5. Nismat nga partnerët zhvillimor

Ekziston një numër i madh i nismave aktuale ose të propozuara nga partnerët zhvillimor të Kosovës që do të ndikojnë në politikat sociale, ndihmën sociale dhe zbutjen e varfërisë në afat të shkurtër dhe të mesëm. Ndoshta projekti më i rëndësishëm është projekti i udhëhequr nga Banka Botërore për zhvillim të punësimit të qëndrueshëm që është në pritje të lëshimit të pjesës së parë të fondeve. Ai synon lidhjen e ndihmës sociale me programet për tregun aktiv të punës, përfshirë angazhimin në punët publike dhe/ose në trajnim kuptimplotë për të lehtësuar tranzicionin nga mirëqenia në punësim. Ai në mënyrë eksplicite përjashton beneficinet e papunësisë në afat të mesëm. Dokumenti i programit përmend se nivelet e beneficinit për ndihmën sociale janë të ulëta.

I rëndësishëm ndoshta të barabartë është programi 2 vjeçar prej 1,8 milion € të mbështetjes së BE-s për programin e MPMS-së që është afër për të filluar. Në mesin e detyrave tjera, kontraktuesi i suksesshëm do të mbështesë Ministrinë në përditësimin e legjislacionit në veçanti në lidhje me tranzicionin nga mirëqenia në punësim, në kuptim të standardeve minimale, dhe në kuptim të decentralizimit. Ky program do të komplementohet me një nismë të financuar nga DFID-i i cili gjithashtu do të mbështesë decentralizimit e mirëqenies sociale, përmes përqendrimit në dimensionet fiskale dhe kalkulimit të transfereve buxhetore.



4

OPSIONET PËR
POLITIKA DHE ZBUTJA E
VARFËRISË

IV: OPSIONET PËR POLITIKA DHE ZBUTJA E VARFËRISË

Ekzistojnë dy pako të përgjithshme të politikave që lidhen me transferet e parave që mund të shfrytëzohen, ndarazi ose së bashku, për të reduktuar varfërinë e fëmijëve në Kosovë. Këtu kemi shënuar ndikimin në reduktim të varfërisë që secila mund të ketë.

4.1. Ndryshimi dhe plotësimi i skemës së ndihmës sociale

4.1.1. Shfuqizimi i pikës ndërprerëse në ndihmën e Kategorisë II për familjet me fëmijë kur fëmija arrin moshën 5 vjeçare

Hëpërhë familja ku një anëtar i familjes është i aftë që të punojë humb kualifikimin për ndihmën e Kategorisë II kur fëmija arrin moshën 5 vjeçare. Në diskutimet e grupit të fokusit kjo është konsideruar si alogjike sa i përket kostos sepse kostoja rritet kur fëmija fillon shkollimin. Ndikimet në zbutje të varfërisë dhe kostot e këtij ndryshimi nuk janë vlerësuar⁴. Mënyra më logjike do të ishte përfshirja e fëmijëve gjer në moshën 15 vjeçare dhe ndoshta edhe përtej gjer në moshën 18 vjeçare nëse janë ende duke vijuar shkollimin. MPMS ka llogaritur se gjatë vitit 2009, 2.951 ekonomi familjare të varfra humbën beneficionet e tëra të tyre pasi që fëmija më i vogël mbushi 6 vjet.

4.1.2. Shtimi i një shume shtesë për beneficion të çdo fëmije të moshës në mes 6 dhe 18 vjeçare

Ky ndryshim është propozuar nga MPMPS për të reflektuar kostot e ngritura të fëmijëve të moshës shkollore. Ky ndryshim do të ndikonte vetëm në ato ekonomi familjare që kualifikohen për ndihmë pasi që kanë një fëmijë të moshës 5 vjeçare. Gassman dhe Roelen (2009) bënë një simulim të politikës në bazë të saj dhe konstatuan se ndryshimi do të ndikonte dukshëm në varfëri në përgjithësi dhe në varfëri të fëmijëve në kufi të varfërisë absolute dhe ekstreme. Përveç kësaj, dallimi

⁴ Kostot dhe ndikimet do të ndryshojnë nga gjendja ku thjeshtë ato ekonomi familjare fëmija më i vogël e së cilave arrin moshën 5 vjeçare vazhdon të pranojë ndihmë sociale, në gjendjen ku një numër i madh i ekonomive familjare të varfra me fëmijë fillojnë aplikimin dhe pranimin e beneficionit .

i varfërisë do të reduktohej (shih tabelën 14)⁵. Ata gjithashtu llogariten koston e ndryshimit duke llogaritur 770,854 fëmijë të moshës 6-18 vjeç që jetojnë në familjet që pranojnë ndihmë sociale (d.m.th. ata nuk morën parasysh gjendjen ku më shumë familje mund të kërkojnë ndihmë sociale nën këto kushte). Kosto është llogaritur të jetë 2,225,270€ në muaj: Me fjalët tjera ngritje prej 354.270€ ose 16.9%, mbi koston aktuale mujore prej rreth 2.1 milion.

4.1.3. Shfuqizimi i shumës maksimale të beneficionit për ekonomitë e mëdha familjare

Përsëri ky ndryshim u propozua nga MPMS, dhe ndërlidhet me faktin se, nën skemën ekzistuese, familjet me shtatë ose më shumë anëtarë pranojnë shumën e njëjtë sikurse ekonomitë familjare me gjashtë anëtarë. Shtimi i 5€ për çdo anëtarë shtesë të ekonomisë familjare nuk bën dallim të madh në normat e varfërisë, kryesisht sepse ekonomitë familjare me shumë anëtarë nuk zënë pjesë të madhe të popullsisë (tabela 14). Në bazë të llogarisë se 25,054 anëtarë shtesë të familjes jetojnë në familjet që pranojnë ndihmë sociale dhe që janë me mbi 7 anëtarë të familjes, kostoja shtesë është 125,270€ në muaj ose rreth 6%. Bashkimi i të dy ideve (1.2 dhe 1.3) do të ngrit koston në gjithsej 2,579,540€ në muaj (ose 22.9% mbi koston aktuale), dhe do të kishte pak ndikim në varfërinë ekstreme në krahasim me ndikimin që do të rezultonte vetëm nga njëra prej ideve nga 1.2 më sipër (tabela 14).

Tabela 15: Ndryshimet në dallimin dhe numërimin e varfërisë për kokë banori me futjen e përshtatjeve në skemën e ndihmës sociale

	Tërë popullsia				Fëmijë			
	Varfëria absolute		Varfëria ekstreme		Varfëria absolute		Varfëria ekstreme	
	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë
Gjendja aktuale	45,3	13,2	16,8	4,0	48,1	14,4	18,3	4,5
Nr i beneficioneve të NS	46,5	15,5	19,4	16,7	49,3	17,4	21,6	8,2
Ngritja në beneficionet e NS për 5€ për fëmijët e moshës 6-18 vjeçare	42,8	11,1	13,2	2,7	44,9	11,6	13,5	2,8
Ngritja në beneficionet e NS për 5€ për çdo anëtarë shtesë të ekonomisë familjare mbi 7 anëtarë	44,6	12,8	16,2	3,6	47,4	13,9	17,4	4,0
Kombinimi i dy përshtatjeve të NS	42,7	11,0	12,7	2,7	44,9	11,5	12,7	2,7

Burimi: Gassmann and Roelen (2009) Tabela 24 f 46 Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

5 Një version më radikal i kësaj ideje do të ngrit beneficionet për çdo fëmijë në bazë të shkallës së ekuivalencës në mes 0.3 dhe 0.75 që janë kufijtë e pikëve të shkallëve të përdorura të ekuivalencës në region, për të reflektuar konsumin plotësues të ndërlidhur me fëmijët. Përsëri ky ndryshim kurrë nuk është simuluar e as kostoja nuk është llogaritur.

4.1.4. Ngritja e shumës së beneficionit të ndihmës sociale në përgjithësi

Një ngritje në nivelin e beneficioneve për 25% ose 50% do të ketë ndikim të rëndësishëm në varfërinë e përgjithshme dhe një rënie më të dukshme në varfërinë e fëmijëve dhe do të shfaqej një rënie të dukshme në dallimin e varfërisë. Megjithatë ndikimi është më i madh për 25% për ngritjen e parë sesa për ngritjen e dytë 25% që sugjeron se 50% i dytë është më pak kosto efektiv (tabela 15). Duke supozuar se nuk joshen përfitues të ri në skemë si rezultat i beneficioneve të larta, supozohet se kostoja e skemës do të ngritet për 25% ose 50%, respektivisht. Në të vërtetë, ligji i propozuar i rishikuar propozon ngritje të indeksuar prej 27,35% ashtu që skenari me ngritje prej 25% mund të merret si përafrim i mirë për ndikimin e këtij ndryshimi.

Tabela 16. Ndryshimi në numërimin e varfërisë për kokë banori me ndryshimet në nivelet e beneficionit në NS

	Tërë popullsia				Fëmijë			
	Varfëria absolute		Varfëria ekstreme		Varfëria absolute		Varfëria ekstreme	
	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë
Gjendja aktuale	45,3	13,2	16,8	4,0	48,1	14,4	18,3	4,5
Ngritja në beneficionet e NS për 25%	42,5	11,1	13,2	2,8	44,6	11,6	13,4	2,8
Ngritja në beneficionet e NS për 50%	41,7	10,8	12,7	2,7	43,5	11,2	12,7	2,7

Burimi: Gassmann and Roelen (2009) Tabela 22 Përlllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

4.2. Paraqitja e skemës së beneficionit për fëmijë

4.2.1. Paraqitja e skemës universale të beneficionit për fëmijë si shtesë ose në vend të skemës së tanishme të ndihmës sociale

Beneficionet për fëmijë janë transfere direkte të parave të gatshme për familjet dhe fëmijët dhe mund të jenë masë efektive kundër varfërisë dhe ndihmojnë zbutjen e kostove shtesë të ndërlidhura me numrin e fëmijëve. Së bashku me pensionin bazik social, ndihma sociale/të ardhurat minimale, dhe shërbimet themelore sociale, ato janë një element i 'bazës së propozuar të mbrojtjes globale sociale' që është parë si e arsyeshme dhe përgjigje efektive ndaj varfërisë (Cerami dhe Stubbs, 2010; Hujo, 2009). Beneficionet universale për fëmijë, përderisa nuk shënjestrojnë familjet e varfra, janë parë si masë efektive kundër varfërisë sepse ato janë të lehta për tu kërkuar dhe administruar, dhe nuk ndërlidhin stigmën me skemat me verifikim të mjeteve materiale. Përderisa në kuptim të efektivitetit ato mund t'i përshtaten në veçanti shoqërive siç është Kosova me norma të larta të fëmijëve në varfëri dhe të fëmijëve që jetojnë pak mbi kufirin e varfërisë, ekziston ngritje-zbritje në kuptim të efektivitetit dhe koston.

Studimi i kohëve të fundit nga Bradshaw dhe Chzhen (2010) shikon ndikimin e normave të ndryshme të beneficionit universal për fëmijë si përpjesëtim i Konsumit Mesatar të Ekonomisë Familjare (KMEF), dhe në marrëdhënie me 4x kufiri i varfërisë. Kjo do të thotë se çdo ngritje prej 5% të KMEF në normën e beneficioneve të fëmijëve do të kishte ndikim në mes 5 dhe 7 pikë bazike të përqindjes në normat e varfërisë së fëmijëve, me beneficionet e fëmijëve në 20% të KMEF ose 24,50€ që pothuajse përgjysmon varfërinë e fëmijëve (tabela 16). Gassmann dhe Roelen (2009) duke shfrytëzuar kufirin e varfërisë absolute, gjithashtu kalkulon se beneficioni universal për fëmijë prej 25€ për fëmijë në muaj do të reduktonte normën e varfërisë për kokë banori nga 45.3% në 27.3% në përgjithësi, dhe 48.1% në 24.9% për fëmijët. Bile do të kishte një efekt më dramatik në varfërinë ekstreme, duke e reduktuar nga 18,3% në 6,6% për fëmijët. Ata modelojnë vetëm gjendjen ku beneficioni i fëmijëve zëvendëson, e nuk e plotëson ndihmën sociale. Ata gjithashtu modelojnë nivelet tjera të beneficionit dhe kufizimet e moshës përfshirë 10€ për të gjithë fëmijët, 10€ për fëmijët nën moshë 5 vjeçare dhe 10€ për fëmijët e moshës 5-15 vjeçare (tabela 17).

Tabela 17: Normat e varfërisë së fëmijëve (4x kufiri i varfërisë së ushqimit) në nivele të ndryshme të beneficionit universal të fëmijëve

	CB=0	CB=5%KMEF	CB=10%KMEF	CB=15%KMEF	CB=20%KMEF
Kosovë	50.5	44.9	38.8	33.5	26.7
KMEF = €122.50		€6.125	€12.50	€18.375	€24.50

Burimi: Bradshaw dhe Chzhen (2010) Tabela 22 f 19

Tabela 18: Ndryshimet në dallimin dhe numërimin e varfërisë për kokë banori me futjen e beneficioneve universale për fëmijë që zëvendëson ndihmën sociale

	Tërë popullsia				Fëmijë			
	Varfëria absolute		Varfëria ekstreme		Varfëria absolute		Varfëria ekstreme	
	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë	Numërimi i varfërisë për kokë banori	Dallimi i varfërisë
Gjendja aktuale	45,3	13,2	16,8	4,0	48,1	14,4	18,3	4,5
Nr i beneficioneve të NS	46,5	15,5	19,4	16,7	49,3	17,4	21,6	8,2
Beneficionet universale për fëmijë (10€)	38,5	11,2	14,2	3,9	39,6	11,9	15,4	4,5
Beneficionet universale për fëmijë (10€) për fëmijët nën moshën 5 vjeçare	44,0	13,4	17,2	4,6	46,4	14,9	19,0	5,5
Beneficionet universale për fëmijë (10€) për fëmijët në moshën 5-15 vjeçare.	41,5	12,4	15,6	4,5	43,1	13,4	17,2	5,4
Beneficionet universale për fëmijë (25€)	27,3	6,9	7,8	1,8	24,9	6,2	6,6	1,6

Burimi: Gassmann and Roelen (2009) Tabela 23 faqe 45 Përllogaritja e autorit nga të dhënat e ABEF 2006-2007

Kostot e beneficionit universal për fëmijë prej 25€ në muaj për çdo fëmijë nën moshën 19 vjeçare llogariten nga Gassman dhe Roelen në 18,1 milion € në muaj ose 217,2 milion € në vit. Kjo është pothuajse 9 herë mbi koston e skemës aktuale të ndihmës sociale dhe do të paraqesë rreth 5% të BPV-së (duke shfrytëzuar llogaritjet e FMN-së për BPV-në 2011),

që është e lartë në krahasim me mesataren e BE-së prej rreth 2% të BP—së për beneficionet për fëmijë dhe familje. Nëse shfrytëzohet në vend të skemës së ndihmës sociale, kostoja do të jetë rreth 16 milion € në muaj. Skema universale prej 10€ do të kushtojë 7,27 milion € në muaj, që është pothuajse saktë 2% e BPV-së së parashikuar për vitin 2011 ku paraqitja e skemës për personat e moshës nën 5 vjeçare do të ishte më pak sesa kostoja e skemës aktuale të ndihmës sociale në 1.35 milion € në muaj ose për ata të moshës 5-15 vjeçare do të kushtonte 4,5 milion € në muaj.

4.2.2. Paraqitja e skemës së beneficionit për fëmijë me verifikim të mjeteve materiale

Përderisa skemat universale të beneficionit për fëmijë janë prevalente në shumë shtete anëtare të BE-së, skema më e zakonshme në EQL-SHPC dhe në EYL është një lloj i skemës së verifikimit të mjeteve materiale (cf UNICEF Innocenti social monitor 2009; 80-84). Këto skema rregullohen me legjislacion, administrohen dhe verifikohen për mjete materiale ndarazi nga skema e ndihmës sociale dhe shpeshherë mund të kenë më pak kushte diskualifikuese që nuk lidhen me të ardhurat. Skemat gjithashtu mund të ndryshojnë nëse ato përfshijnë pranimin e ndihmës sociale si të ardhura. Disa nga shtetet në regjion paguajnë beneficionet e fëmijëve gjër në moshën shkollare vetëm nëse ka dëshmi të vijimit në shkollë. Disa shtete paguajnë beneficionet për fëmijë me aftësi të kufizuara me kufi më të lartë të moshës. Nuk janë modeluar kostot ose efektet e zbutjes së varfërisë së beneficioneve për fëmijë në bazë të verifikimit të mjeteve materiale, edhe pse kostoja dhe efektet e reduktimit të varfërisë do të varen nga niveli i beneficionit dhe nivelit të përdorur të verifikimit të mjeteve materiale.

Përveç kësaj ecja përpara kah qasja më e Evropianizuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit social të fëmijëve do të kërkojë një qasje strategjike me shumë dimensione dhe të bashkërenduar. Në këtë kontekst janë me rëndësi një numër i çështjeve si vijon:

- i. Përfshirja e zotimit për reduktim të varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve brenda strategjisë së zhvillimit kombëtar dhe gjithëpërfshirjes sociale, duke shfrytëzuar një kornizë të qartë në kuptim të qëllimeve, veprimeve, treguesve dhe rezultateve.
- ii. Sigurimi i një qasje më të bashkërenduar në nivel lokal në mes të transfereve të parave të gatshme dhe vlerësimit të shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet e cenushme përmes vlerësimeve të qarta dhe qasjeve moderne të menaxhimit të rasteve.
- iii. Caktimi i zhvillimit në fëmijëri të hershme si prioritet në veçanti në fushat më të brishta dhe në komunitetet në rrezik më të madh të përjashtimit siç janë romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.



5

PËRFUNDIME DHE
HAPAT E
ARDHSHËM

V: PËRFUNDIME DHE HAPAT E ARDHSHEM

Prioritetet afatshkurtra (gjatë vitit 2010)

1. Ligji për Ndhimë Sociale duhet të përgatitet dhe të dërgohet sa më shpejtë që është e mundur në Parlament, në bazë të tri ndryshimeve dhe plotësimeve kryesore që do të përfshihen në Ligjin e kthyer nga Parlamenti dhe në draft Letrën e Bardhë, do të thotë:
 - *Indeksi i niveleve të beneficionit në të kaluarën për të mbuluar koston e ngritur të shportës së ekonomisë familjare. Ngritja është kalkuluar në 27.35%. Kalkulimet sugjerojnë se ngritja e tillë do të reduktonte varfërinë e përgjithshme për rreth 2.8 pikë bazë të përqindjes (bps) dhe varfërinë të fëmijët për 3.5 bps, gjithashtu me reduktime të rëndësishme në nivelet e varfërisë ekstreme, në veçanti në mesin e fëmijëve, dhe në dallimin e varfërisë.*
 - *Ngritja e beneficionit që i paguhet fëmijëve të moshës shkollore (d.m.th. 6-18) për 5€ që vijojnë rregullisht mësimin. Kjo do të kishte ndikim të ngjashëm dhe plotësues në normat e varfërisë dhe dallimet e varfërisë.*
 - *Mënjanimi i kufijve të sipërm të benificioneve të ekonomive familjare ashtu që familjet me 8 ose më shumë anëtarë të marrin nga 5€ shtesë për secilin anëtar. Kjo nuk do të vlejë për një numër të madh të familjeve prandaj nuk do të kishte ndikim të madh në normat e përgjithshme të varfërisë, por në kosto relativisht të ulët, do të reduktonte dukshëm varfërinë në ekonomitë e mëdha familjare. Marrë së bashku, tri masat mund të reduktojnë normat e varfërisë së fëmijëve në Kosovë gjer në 8 bps, duke ulur normën në rreth 40%.*
2. Vlerësimi i radhës i varfërisë nga Enti Statistikor i Kosovës/Banka Botërore, duke shfrytëzuar të dhënat e fundit nga ABEF duhet të ketë përqendrim special në varfërinë e fëmijëve përfshirë kalkulimin e normave të varfërisë, në normat e rrezikut për fëmijët e moshave të ndryshme, në llojet e ndryshme të ekonomive familjare, në viset rurale dhe urbane, etj. Studimi gjithashtu, nëse është e mundur, duhet të nënvizojë skenarët e ndryshëm të politikave për transferet e parave dhe do të kalkulojë ndikimet e tyre në varfërinë e fëmijëve.

3. Si pjesë e përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE dhe pjesëmarrje në Metodën e Hapur të Bashkërendimit në mbrojtjen sociale dhe gjithëpërfshirjen sociale, duhet të mbahet një konferencë me fokus special në Varfërinë dhe Përrjashtimin e Fëmijëve. Konferenca mund të jetë partneritet në mes të autoriteteve Kosovare, Komisionit Evropian, UNICEF-it dhe të tjerëve. Përveç shtrimit së çështjeve në lidhje varfërinë dhe përjashtimin e fëmijëve, konferenca mund të diskutojë opsionet për politika dhe të mësojë nga praktikat më të mira në shtetet anëtare, shtetet kandidate dhe shtetet me perspektivë që të bëhen shtete kandidate. Një rezultat i dëshirueshëm i konferencës mund të jetë që çështja e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve të shënohet si fokus në raportin vjetor të progresit që nxirret nga Komisioni Evropian për Kosovën nën Strategjinë për Zgjerim të BE-së.
4. Një numër i programeve dhe projekteve janë në proces të dizajnit ose zbatimit, ku të gjitha kanë komponentë që mund të ndërliohen me çështjet e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Përpjekjet e UNICEF-it për ndërliohje të ngushtë me partnerët bashkëpunues do të sigurojnë shfrytëzimin në maksimum të mundësive për të siguruar qasjet koherente për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Këto përfshijnë:
 - *Projektin shumëdonatorësh/Banka Botërore për politikë të zhvillimit të punësimit të qëndrueshëm (SEDPP).*
 - *Mbështetjen e financuar nga BE (IPA) për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).*
 - *Programin e propozuar i financuar nga DFID për decentralizimin e Shërbimeve të Kujdesit Social.*

Prioritetet afatmesme (2011-13)

5. Mund të ekzistojë nevoja për të siguruar asistencë teknike për Qeverinë (në veçanti për MPMS dhe MEF) me qëllim të ndërtimit të kapacitetit për modelim të politikave dhe skenarëve në kuptim të opsioneve të qarta për reduktim të varfërisë së fëmijëve në Kosovë përmes transfereve të parave të gatshme. Një nga prioritetet e para duhet të jetë eksplorimi i mundësisë së zgjerimit të Ndhmës Sociale të Kategorisë II për ato familje që bien jashtë kritereve të pranueshmërisë vetëm sepse nuk kanë më asnjë fëmijë nën moshën 6 vjeçare por kanë fëmijë të moshës shkollore.
6. Në afat të mesëm dhe të gjatë Kosova mund të merr parasysh, sikurse shumica e fqinjëve të regjion, paraqitjen e skemës së beneficionit për fëmijë. Përderisa skema universale e beneficionit për fëmijë prej 25€ për fëmijë në muaj llogaritet se do të përgjysmojë normat e varfërisë së fëmijëve në Kosovë, gjetja e hapësirës fiskale për këtë do të ishte e vështirë, përveç nëse bëhen kursime të rëndësishme gjetiu. Beneficionet universale ose me verifikim të mjeteve materiale në nivel prej 10€ në muaj, për të gjithë fëmijët, për fëmijët nën moshën 5 vjeçare, për fëmijët e moshës 5-15 vjeçare, mund të ketë ndikim të rëndësishëm në normat e varfërisë së fëmijëve. Beneficionet universale për fëmijë kanë kosto më të ulët administrative, arrijnë te fëmijët në ekonomitë familjare që marrin paga, dhe edhe pse janë më të shtrenjta sesa skemat mesatare, mund të kombinohen me sistemet tatimore për të rikuperuar disa shpenzime për ekonomitë familjare jo të varfra. Këtu gjithashtu mund të ekzistojë mundësia e lidhjes së mbështetjes direkte buxhetore në kuptim

të reduktimit të varfërisë dhe përjashtimit të fëmijët dhe sigurimit të buxhetimit qendror dhe lokal i përgjigjet fëmijëve dhe aspektit gjinor. Një qasje me fazë për një lloj të skemës së beneficioneve më gjithëpërfshirëse për fëmijë është ndoshta skenari më i mirë, që kërkon vullnet të fuqishëm politik dhe ricaktim të prioriteteve të shpenzimeve publike.

7. Në kuptim të vullnetit politik, ngritja e vetëdijes për varfërinë dhe përjashtimin e fëmijëve në mesin e të gjitha partive politike dhe në veçanti në mesin e parlamentarëve mund të jetë mjet efektiv për sigurimin e ndjeshmërisë më të madhe të fëmijëve në politikë bërjen në përgjithësi. Kjo mund të ndërtohet mbi punën tanimë të kryer me Parlamentarët për çështjet e përfshirjes sociale. Në afat të shkurtër Kosova duhet të përgatis Strategjinë e Gjithëpërfshirjes Sociale në linjë me ato të kërkuara në kuptim të Memorandumit të Përbashkët të Gjithëpërfshirjes për shtetet kandidate ashtu që brenda saj kërkohet përqendrimi në qasjen e koordinuar dhe efektive për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve duhet gjithashtu të jetë prioritet brenda strategjisë kombëtare për zhvillim, së bashku me kujdesin më të madh në nivel lokal ndaj bashkëveprimit në mes të transfereve të parave të gatshme dhe shërbimeve sociale, caktimit të prioritetit për arsimin në fëmijërinë e hershme, dhe sigurimin e strategjive të përqendruara për përfshirje të grupeve dhe regjioneve të marginalizuara.

REFERENCAT

1. Bradshaw, J. dhe Y. Chzhen (2010) Varfëria e fëmijëve në pesë shtete të EQL/SHPC, SPRU, Universiteti i York, Draft studim për Zyrën Regjionale të UNICEF-it për EQL-SHPC.
2. Banka Qendrore e Kosovës (2009) Buletini mujor statistikor, nëntor, numri 98, Viti VIII. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.
3. Chzhen, Y. (2008) Varfëria e fëmijëve në Kosovë: Analizën e ABEF 2006/2007, SPRU, Universiteti i York, Mbretëri e Bashkuar, Studim për UNICEF, Kosovë.
4. Komisioni Evropian (2008) Raport i përbashkët për mbrojtjes sociale dhe gjithëpërfshirjen sociale. Bruksel: Komisioni Evropian.
5. Gassman, F. Dhe K. Roelen (2009) Ndikimi i skemës së ndihmës sociale me para të gatshme në Kosovë, Universiteti i Maastricht, Holandë, Studim për UNICEF, Kosovë.
6. Gueorguieva, A. (2007) Dokument politik për reformat në energji, nëntor. Uashington: Banka Botërore.
7. Gueorguieva, A. (2008) 'Programi i mirë, investimi i mirë: Dokument politik për programin e Kosovës për ndihmë sociale', Uashington, Banka Botërore, prill. Uashington.
8. Qeveria e Kosovës (2009) Korniza Afatmesme e Shpenzimeve. Prishtinë.
9. HMO Solutions (2008) Profil i varfërisë së fëmijëve dhe të rinjve në Kosovë: Rishikim në zyrë, Studim për UNICEF, Kosovë.
10. Hoelscher, P. (2004) Studim tematik për varfërinë e fëmijëve. Bruksel: Komisioni Evropian.
11. KFOS/COMPASS (2009) Gjendja e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë: anketë bazë. KFOS. Faqja në internet: http://www.kfosweb.info/pdf/The%20Position%20of%20RAE%20Communities%20in%20Kosovo%20Baseline%20Survey_ENG.pdf
12. Marlier, E. et al (2007) BE-ja dhe gjithëpërfshirja sociale: përballja me sfida. Bristol: Policy press.
13. USAID/UNDP (2009) Mozaiku i Kosovës: shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus. Faqja në internet: <http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/english%20green.pdf>

14. Stubbs, P. dhe A. Haxhikadrija (2008) Mbrojtja sociale dhe gjithëpërfshirja sociale në Kosovë nën RKS KB 1244. Raport për Komisionin Evropian, Faqja në internet: http://ec.europa.eu/employment_social/spsi/docs/social_inclusion/2008/kosovo_en.pdf
15. Toçi, I. (2010) Zhvillimet dhe të arriturat e BQK-së gjatë vitit 2009. Banka Qendrore e Kosovës. Faqja në internet: <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/Zhvillimet-ekonomike-2009ang.pdf> (i vizituar më 21 shkurt 2010).
16. UNICEF (2010) UNICEF Kosovë. Faqja në internet: <http://www.unicef.org/kosovo/>
17. Banka Botërore (2007) Çështjet dhe rekomandimet nga dokumenti politik për shpenzimet publike për arsimin para-universitar në Kosovë: Referim tremujor ekonomik i Kosovës, tetor-dhjetor.
18. Banka Botërore/KSO (2008) Vlerësimi i varfërisë në Kosovë vol. 1, Faqja në internet: <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/KOSOVOEXTN/0,,contentMDK:21761784~menuPK:297788~pagePK:64027988~piPK:64027986~theSitePK:297770~isCURL:Y,00.html>
19. Banka Botërore (2010) Kriza godet shtëpinë: testimi i stresit në ekonomitë familjare në Evropë dhe Azi Qendrore, Uashington: Banka Botërore, Faqja në internet: http://siteresources.worldbank.org/ECAEXT/Resources/258598-1256842123621/6525333-1259681048367/WorldBank_Crisis_Report.pdf



United Nations Children's Fund – UNICEF
Ali Pashë Tepelena, Nr. 1
10000, Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 38 249 230
Fax +381 38 249 234
prishtina@unicef.org
www.unicef.org/kosovo